




МИНИСТЕРСТВО ЗА ОБРАЗОВАНИЕ И НАУКА - БИРО ЗА РАЗВОЈ НА ОБРАЗОВАНИЕТО  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS - BYROJA E ZHVILLIMIT TE ARSIMIT  
MINISTRY OF EDUCATION AND SCIENCE - BUREAU FOR DEVELOPMENT OF EDUCATION

**PROGRAMI: ARSIMI INKLUZIV NË  
SHKOLLAT FILLORE**

## SHKOLLA INKLUZIVE

# • • • Udhëheqësi PËR PUNËN E EKIPIT INKLUZIV SHKOLLOR

- botimi i dytë i reviduar -





PROGRAMI:  
ARSIMI INKLUZIV  
NË SHKOLLAT FILLORE


# SHKOLLA INKLUZIVE

## Udhëheqësi

për punën e  
ekipit inkluziv shkollor

- botimi i dytë i reviduar -

Shkup, Viti 2020



**Botuesi:**  
**Byroja për zhvillimin e arsimit**

**Autorë:**  
M-r Boshkovska Rozalija  
Ivanovska Milka  
M-r Mickovska Gorica  
Mojanovska Vangelina  
M-r Pankova Dushanka  
Petroviq Elizabeta  
Peshevska Mitansovska Aleksandra  
M-r Tërpevska Snezhana  
M-r Çonteva Zhaneta

**Redaksia profesionale:**  
M-r Anica Aleksova

**Revizioni i botimit të dytë**  
M-r Mickovska Gorica  
Tasevska Andrijana  
M-r Tërpevska Snezhana  
M-r Çonteva Zhaneta

**Lektorimi:**  
Valentina Joshevska

**Përkthimi në gjuhën shqipe:**  
M-r Satki Ismaili

**Dizajni**  
Brigada

**Shkollat të cilat kanë pilotuar versionin e punës të udhëheqësit:**

SHF “Krumë Kepeski” - Shkup  
SHF “Joakim Kërçoski” - Shkup  
SHF “Vasil Gllavinov” - Veles  
SHF “Kole Kaninski” - Manastir  
SHF “Grigor Përliçev” – Ohër  
SHF “Mançu Matak” - Krivogashtani

CIP – Katalogizimi në publikimin e bibliotekës Nacionale dhe universitare “Shën Kirili i Ohrid”, Shkup

376.3:373.3(036)

Shkolla INKLUZIVE : udhëheqësi për punë të ekipit inkluziv shkollor / [autorë Boshkovska Rozalija ... etj.]. - Shkup: Byroja për zhvillimin e arsimit, 2018. - 190 faq. : ilustr. ; 20 cm

Fusnotat e tekstit. - Autorë: Boshkovska Rozalija, Ivanovska Milka, Mickovska Gorica, Mojanovska, Vangelina, Pankova Dushanka, Petroviq Elizabeta, Peshevska Mitansovska Aleksandra, Tërpevska Snezhana Çonteva Zhaneta. – Përmban edhe: Shtojcë

ISBN 978-608-206-060-6

1. Boshkovska, Rozalija [autor]

a) Arsimi inkluziv - Udhëheqës

COBISS.MK-ID 105908234

Autorët ju faleminderohen ekipeve inkluzive nga shkollat fillore të cilët gjatë vitit shkollor 2016/17 kanë zbatuar procedurat dhe instrumentet e propozuara. Ditarët e tyre refleksiv dhe informatat kthyes mundësuan që të përgatitet versioni final i këtij doracaku.

Qëndrimet e dhëna në këtë doracak janë të autorëve dhe nuk do të thotë se përshtaten me qëndrimet dhe politikat e UNICEF-it.

Ky botim i dytë Botimi është përgatitur nga fondi i KB Partneriteti për të drejtat e e personave me pengesa (UNPRPD) nëpërmjet të Zyrës së UNICEF në Shkup dhe Qendrës maqedonase për arsim qytetar dhe shoqatës Hapni dritaret.

# PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE	4
HYRJE	5
ARSIMI INKLUZIV DHE EKUPI INKLUZIV SHKOLLOR	7
1. ÇFARË ËSHTË ARSIMI INKLUZIV	7
2. Arsimi inkluziv nëpërmjet akteve normative	9
3. Ekipe të inkluzive në shkollë	13
PROTOKOLET DHE INSTRUMENTET PËR PUNËN E EKIPIT INKLUZIV SHKOLLOR	15
Fusha 1. Përfshirja dhe kyçja e nxënësve	15
1.1. Përfshirja e nxënësve	15
1.2. Kyçja dhe pjesëmarrja e nxënësve në mësim, në aktivitetet jashtëmësimore dhe të lira të nxënësve	18
SHEMBUJ TË INSTRUMENTEVE DHE MODELE TË DOKUMENTEVE PËR FUSHËN	19
Fusha 2. Planifikimi i punës edukativo-arsimore	42
Planifikimet zhvillimore dhe vjetore në shkollë	42
Përkrahja në planifikimin e mësimit	43
SHEMBUJ TË INSTRUMENTEVE DHE MODELE TË DOKUMENTEVE PËR FUSHËN	45
Fusha 3. Përkrahja e mësimit dhe mësimnxënies	101
Përkrahja e mësimit	101
Përkrahja e mësimnxënies	101
SHEMBUJ TË INSTRUMENTEVE DHE MODELE TË DOKUMENTEVE PËR FUSHËN	103
Fusha 4. Përkrahja e nxënësve	120
Kujdesi i përgjithshëm për nxënësit	120
Përcjellja e përparimit	121
SHEMBUJ TË INSTRUMENTEVE DHE MODELE TË DOKUMENTEVE PËR FUSHËN	122
Fusha 5. Raporti partnerial me prindët, bashkësinë lokale dhe komunitetin e biznesit	148
Bashkëpunimi me prindët	148
Bashkëpunimi me bashkësinë lokale	149
Bashkëpunimi me komunitetin e biznesit dhe me sektorin joqeveritar	150
SHEMBUJ TË INSTRUMENTEVE DHE MODELE TË DOKUMENTEVE PËR FUSHËN	151
Fusha 6. Mbledhja e informacioneve, analiza dhe evaluimi i inkluzionit	160
Mbledhja e informacioneve	160
Analiza dhe evaluimi i inkluzionit	161
SHEMBUJ TË INSTRUMENTEVE DHE MODELEVE TË DOKUMENTEVE PËR FUSHAT	163

## LISTA E SHKURTESAVE

<b>EISH</b>	Ekipi inkluziv shkollor
<b>EIN</b>	Ekipi inkluziv për nxënës
<b>NVA</b>	Nevojat e veçanta arsimore
<b>AI</b>	Arsimi inkluziv

## HYRJE

Versioni i parë i Udhëzuesit për punën e ekipit inkluziv shkollor është i përgatitur në kuadër të programit *Arsimi Inkluziv në shkollë fillore i cili është e finansuar nga zyra e UNICEF-it*. Me qëllim ti përkrah aktivitetet e Ministrisë për Arsim të orientuara drejt realizimit të të drejtave të fëmijëve për qasje dhe kyçje në arsim, si dhe përmirësimin e të arriturave nëpërmjet sigurimit të kualitetit më të lartë të arsimit për të gjithë fëmijët.

Duke patur parasysh se arsimi inkluziv i ka specifikat e veta në vendosjen sistimore në përmbajtjet dhe në organizimin e veprimtarisë edukativo-arsimore, u paraqit nevoja për revidimin e Udhëheqësit për punë të ekipit inkluziv shkollor dhe përshtatjen e saj me zgjidhjet e fundit ligjore<sup>1</sup> dhe konceptuale për arsimin inkluziv<sup>2</sup>.

Shkollat të cilat ishin të inkuadruara në programin Arsimi inkluziv në shkollat fillore janë në njëfarë përparësie sepse më veç kanë mbajtur trajnime dhe aktivitete të ndryshme nëpër shkollat të orientuara drejtë kuptimit më të mirë të arsimit inkluziv dhe forcimin e kapaciteteve të shkollave për “punë me grupe të ndryshme nxënësish... sigurimin e pjesëmarrjes dhe ta nxisin mësimin”<sup>3</sup>. Pjesë nga trajnimet dhe aktivitetet kanë të bëjnë me formimin e ekipeve dhe zhvillimin e bashkësive për inkluzion. Këto shkolla formojnë ekipe inkluzive shkollore (EISH), arritën përvoja në punën e tyre dhe janë të përgatitura në punën e tyre dhe janë të përgatitura që ato t’i ndajnë me shkollat tjera. Pjesë nga këto përvoja dhe materiale janë përfshirë në këtë Udhëheqës.

**Nga praktikantët – për praktikantët.** Udhëzuesi është i përgatitur nga praktikantët – anëtarë të ekipeve inkluzive nga shkollat të cilat janë pjesë e programit<sup>4</sup>. Para së gjithash është i dedikuar për anëtarët e ekipeve shkollore inkluzive. Ai duhet që t’i ndihmojë në planifikimin, realizimin dhe dokumentimin e punës të EISH.

Udhëzuesi mund të ndihmojë që të punësuarit në shkollë më mirë ta kuptojnë rolin e EISH, ndërsa kuadrit udhëheqës mund t’i ndihmojë në krijimin e sistemit të mirë për përkrahje të nxënësve me NVA dhe në krijimin e kulturës shkollore inkluzive. Udhëzuesi, gjithashtu, mund të ndihmojë edhe për vetëevalimin dhe promovimin e inkluzionit në shkollë.

Autorët e Udhëzuesit nisen nga ideja se secili mund të mësojë dhe t’i përmirësojë kompetencat e tij dhe punën. Ajo do të ishte dashur të jetë ideja udhëheqëse e të gjithëve të cilët punojnë në ekipet inkluzive. Me atë qëllim i shpërndajnë dijet e tyre të deritanishme dhe idetë për punën e ekipit shkollor inkluziv dhe njëkohësisht janë të hapur për përvoja dhe propozime të kolegëve. Versioni i parë i udhëzuesit ishte që si provë të shfrytëzohet në gjashtë shkolla fillore në periudhë gati se një vit shkollor. Shqyrtimet dhe sugjerimet të ekipeve inkluzive nga këta shkolla janë shqyrtuar së bashku me autorët e udhëzuesit si rezultat i së cilës doli ky version. Udhëzuesi edhe më tej mund të plotësohet dhe përmirësohet si rezultat i përvojes nga praktika.

<sup>1</sup> Ligji për arsimin fillor: Gazeta zyrtare RMV, nr. 161 nga 5.8.2019.

<sup>2</sup> Koncepti për arsimin inkluziv, <http://mon.gov.mk/stored/document/Koncepcija%20za%20inkluzivno.pdf>

<sup>3</sup> HolenvegerXH., me pjesëmarrje të Paula Frederika Hant dhe Nora Shabani, Shkup : Byroja për Zhvillimin e Arsimit, 2015. Dorracak për Arsimi inkluziv, Byroja për Zhvillimin e Arsimit, 2015, faqe 7, <https://www.unicef.org/tfymacedonia/resources.html>

<sup>4</sup> Në tekstin e mëtuftjeshëm fjala Programë ka të bëjë me programin Arsimi Inkluziv në shkollën fillore.

## Çfarë është, ndërsa çfarë nuk është Udhëzuesi

Udhëzuesi, përmban përmbledhje protokolesh<sup>5</sup> të cilat e drejtojnë punën e EISH dhe instrumente të cilat e lehtësojnë dhe dokumentojnë punën. Ato janë të nënrenditura sipas fushave të cilat nga njëra anë, e ndjekin logjikën e rendit të aktiviteteve të EISH gjatë vitit shkollor, ndërsa në anën tjetër, në masë të madhe, janë të përshtatura me fushat të planifikimit zhvillimor të shkollës. Janë të grupuara në 6 fushat gjegjëse:

1. Përfshirja dhe pjesëmarrja e nxënësve;
2. Planifikimi i punës edukativo-arsimore;
3. Përkrahja e arsimtarëve dhe mësimi;
4. Përkrahja e nxënësve;
5. Marrëdhëniet e partneritetit me prindërit, me bashkësinë vendore dhe komunitetin e biznesit;
6. Analiza dhe evaluimi i inkluzionit.

Protokolet në çdo fushë janë të grupuara në nënfusha. Në fillim të çdo fushe dhe nënfushe është dhënë një qasje e shkurtër e rëndësisë së aktiviteteve të EISH në kuadër të asaj fushe.

Gjithkund ku autorët mendojnë se mund të ofrojnë instrumente<sup>6</sup> të cilat do ta lehtësojnë / drejtojnë punën e EISH ata janë dhënë si shtojcë. Ndonjëherë janë dhënë më shumë se një verzion të instrumentit me të njëjtën/ përdorim të ngjashëm, a me qëllim që shfrytëzuesit që të mund ta zgjedhin verzionin të cilin e konsiderojnë si më adekuat ose të marrin ide për përgatitjen të instrumenteve të veta.

As protokolet e as instrumentet nuk duhet të kuptohen si mënyra të vetme të mundshme dhe të vetmet mënyra të mira për punë të EISH. Ata janë vetëm “ndihma e parë” e të sapo formuarëve dhe jo aq me përvojë të EISH. Gjatë rrjedhës së punës çdo EISH-i, në varësi nga politikat zhvillimore shkollore, përvojat e marra, kushtet në të cilat mëson, resurset me të cilat disponon, mund t’i përshtatë protokolet e propozuara dhe instrumentet.

Udhëzuesi nuk është doracak për arsimi inkluziv. Mendohet se anëtarët e EISH duhet të kenë njohuri për konceptin për inkluzion social dhe se e njohin, rrethin e veprimit të punës së tyre, shfrytëzonin repertoar më të gjërë të procedurave të cilat sigurojnë pjesëmarrje dhe mësim të të gjithë fëmijëve, në veçanti të atyre me NVA.

<sup>5</sup> Protokoli në këtë Udhëzues ka të bëjë me procedurë të kontraktuar që duhet të ndiqet në situatë të caktuar.

<sup>6</sup> Instrumentet janë të përpunuar nëpër shkollat në të cilat punojnë autorët ose janë marrë/adaptuar nga autorë tjerë.



# ARSIMI INKLUZIV DHE EKIPI INKLUZIV SHKOLLOR

## 1. Çfarë është Arsimi Inkluziv

Sintagma arsimit inkluziv është një nga më të përdorurat kohëve të fundit, gjatë së cilës takohen definicionet e ndryshme dhe të kuptuarit e kuptimit të tij. Në kontekst të këtij udhëzuesi nuk do të ndalemi detalisht në sqarimin se çfarë është arsimit inkluziv, por për kuptimin e njëtrajtshëm do të udhëhiqemi me sa vijon <sup>7</sup>:

Arsimi inkluziv është proces i daljes në ndihmë dhe përgjigje të nevojave të ndryshme të fëmijëve, të rrinjëve dhe të rriturve nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes në mësim, në shkollë dhe në bashkësinë.

Ajo bashkangjet edhe përmbajtje arsimore të modifikuara, qasje, organizatash dhe strategji që të sigurohet arsim kualitativ për të gjithë.

Arsimi inkluziv nënkupton se të gjithë nxënësit, pavarësisht nga veçantitë e tyre, janë të kyçur dhe të pranuar.

Arsimi inkluziv vëmendje të veçantë i përkushton kyçjes së atyre fëmijëve që mundet të jenë të marginalizuar, diskriminuar ose të përjashtuar

nga sistemi arsimor<sup>8</sup>. Ata, pa marrë parasysh potencialet e tyre ose dobësitë në disa fusha, kyçen në klasat e rregullta dhe ju sigurohen kushte përkatëse për mësim, përparim dhe pjesëmarrje në jetën shkollore.

Nevoja për inkluzion në arsim dhe kërkimi i mënyrave se si të sigurohet më mirë, janë aktuale veçanërisht në 20 vjetët e fundit dhe dukshëm janë miratuar në dokumente ndërkombëtare të cilat mundohen për arsim kualitativ për të gjithë<sup>9</sup> dhe lëvizjet e ndryshme profesionale për përjetësimin e tyre në praktikë. Arsimi tradicional, “i barabartë” për të gjithë, u tregua se nuk mund të sigurojë arsim kualitativ për të gjithë. Për atë është e nevojshme që ajo të përshtatet për nevojat e grupeve dhe individëve të ndryshëm.

<sup>8</sup> Sipas definimit operativ të UNESCO ata janë kategoritë vijuese të nxënësve:

**A/Pengesa:** Nxënësit me pengesa ose çrregullime në kuptime medicinale ose çrregullime organike të cilët mundet të lidhen me patologjinë organike (si p.sh. lidhur me mungesa sensorike, motorike ose neurologjike. Nevojat e veçanta arsimore dalin nga këta pengesa;

**B/Vështirësi:** Nxënës me çrregullime në sjellje ose emocione ose vështirësi specifike në mësim. Nevojat e veçanta arsimore dalin fillimisht nga interaksioni ndërmjet nxënësit dhe kontekstit arsimor;

**C/Deprivimi:** Nxënësit vështirësitë e të cilëve dalin nga faktorët socio-ekonomik, kulturologjik dhe/ose gjuhësor. Nevojat e veçanta arsimore kanë të bëjnë me plotësimin e papërshtatshmërive të cilat dalin nga faktorët e përmendur“. (Policy Guidelines on Inclusion in Education, UNESCO 2009, <http://unesdoc.unesco.org/images/0017/001778/177849e.pdf>)

<sup>9</sup> - Salamanca Statement and Framework for Action on Special-Needs Education (1994), [http://www.unesco.org/education/pdf/SALAMA\\_E.PDF](http://www.unesco.org/education/pdf/SALAMA_E.PDF)


- Council of Europe, Political Declaration (2003) and Action Plan (2006), [https://search.coe.int/cm/Pages/result\\_details.aspx?ObjectID=09000016805af657](https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016805af657)

- United Nations International Convention on the Rights of Persons with Disabilities (2006), <http://www.un.org/esa/socdev/enable/rights/ahc8adart.htm>

<sup>7</sup> Të bazuar në: UNESCO 2009, Policy Guidelines on Inclusion in Education, faqe. 8-9 <http://unesdoc.unesco.org/images/0017/001778/177849e.pdf> и UNICEF, 2012, The Right of Children with Disabilities to Education: A Rights-Based Approach to Inclusive Education, faqe. 10-11, [https://www.unicef.org/ceecis/IEPositionPaper\\_ENGLISH.pdf](https://www.unicef.org/ceecis/IEPositionPaper_ENGLISH.pdf)

Për ndërtimin e shkollës inkluzive, është e nevojshme që procesi edukativo-arsimor të konceptohet në modelin e intervenimeve për përkrahje në më shumë nivele (Multi-tiered intervention model). Ky model përfshin transformime/intervenime në planin mësimor dhe programeve mësimore, strategjitë mësimore, aktivitete dhe materiale, si dhe përcjellje në kontinuitet të procesit të realizimit të intervenimeve, në më së paku tre nivele të përkrahjes së mësimin:

- **Niveli themelor** – programet e përshkruara dhe metodave të rekomanduara janë adekuate për numrin më të madh të nxënësve (rreth 80 %) dhe ata nuk janë të nevojshme përshtatje të veçanta që të mund suksesshëm ta ndjekin mësimin.
- **Niveli I** – Përkrahje e përgjithshme –për këtë lloj përkrahje vendos shkolla në bashkëpunim me nxënësin dhe prindërit/kujdestarin e tij dhe gjatë kësaj nuk ka nevojë për vendim zyrtar. Përkrahja e përgjithshme sigurohet në kuadër të shkollës përgjatë së cilës përveç arsimtarit bashkangjiten edhe bashkëpunëtorët profesional të cilët mbanë evidencë për përparimin e nxënësit. Mësimi duhet të drejtohet drejt individualizimit dhe diferencimit të procesit mësimor me zbatimin e metodave mësimore adekuate dhe mjeteve.
- **Niveli II** – Përkrahja intensive – arrihet te nxënësit në rast kur përkrahja e përgjithshme nuk i jep rezultatet e pritura. Rekomandim për dhënien e përkrahjes intenzive bëhet pas vlerësimit të bërë nga ana e ekipit inkluziv të shkollës dhe Organeve profesionale për vlerësim funksional. Përkrahja intensive është me intervenime shumëkahëshe dhe /ose intervenime të njëkohshme dhe i sigurohet nxënësit në bazë të planit individual arsimor.
- **Niveli III** – Përkrahja e veçantë sigurohet kur përkrahja intensive nuk i plotëson nevojat e nxënësit ose në rast tjetër, pasi që është sjell rekomandimi për dhënien e përkrahjes së veçantë pas vlerësimit të bërë nga ana e trupave profesionale për vlerësim funksional. Përkrahja e veçantë është e ngjashme si përkrahja intensive, Por edhe më tej është me intenzitet më të madh dhe intervenime njëkahëshe dhe shumëkahëshe dhe /ose intervenime të njëkohshme dhe sigurohet në bazë të programës mësimore të modifikuar.



Fotoja 1. Niveli i përshtatjes së punës edukativo-arsimore

Të gjitha tre nivelet të përkrahjes sigurohen në shkollat e rregullta, në bashkëpunim me prindërit/kujdestarët, ndërsa në nteresin më të mirë të nxënësit. Po qe se përkrahja e veçantë e cila jepet në shkolla nuk i plotëson nevojat e nxënësit, ekziston mundësia përkrahja të sigurohet edhe në shkollat fillore me qendrën e resurseve ose qendrat për përkrahje të mësimin. Format e përkrahjes janë të definuar në programën e modifikuar mësimore.

Sipas përcaktimeve në dokumentet konceptive të arsimin fillor në Republikën e Maqedonisë “arsimtarët dhe shkolla kanë përgjegjësi të veçantë ndaj nxënësve të cilat për shkaqe të ndryshme kanë pengesa në mësim dhe në të arriturat e qëllimeve arsimore, e cila vjen në shprehje në përshtatje të përmbajtjeve dhe metodave në mësim ndaj tempove të ndryshme në përparimin e nxënësve”<sup>10</sup>

Pedagogjia inkluzive e cila promovohet në projektin Arsimi inkluziv në shkollën fillore dhe është e bazuar në vlerat përcaktuese profesionale gjegjëse:

- Pjesëmarrja e vërtetë është parakusht për mësim.
- Çdo fëmijë mund të mësojë.
- Plani mësimor dhe programi janë mjete për zhvillimin e aftësive – jo për akumulim të informacioneve dhe fakteve.

<sup>10</sup> Konepti për edukim dhe arsim fillor nëntëvjeçarë, faqe. 67, MASH, BZHA, 2007, <http://www.bro.gov.mk/index.php?q=mk/search/node/%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D1%86%D0%B5%D0%BF%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0#>

- Arsimtarët dhe shkollat përshtaten ndaj nxënësve – dhe jo anasjelltas.
- Dallueshmëria nënkuptohet si mundësi për mësim, e jo si pengesë për mësim.
- Vëmendje e veçantë i kushtohet pengimit të:
  - diskriminimit
  - marginalizimit
  - shkyçjes
  - rezultatet e dobëta të nxënësit

Mësimin në klasë të njëjtë nuk do të thotë mësim të punës së njëjtë në të njëjtën kohë.

*(sipas Xhudit Holenveger)*

Ekipi shkollor inkluziv edhe pse kujdeset për kyçjen e gjithë nxënësve, punën e fokuson te nxënësit të cilëve u është e nevojshme përkrahje nga niveli I, II dhe III.

## 2. Arsimi inkluziv nëpërmjet akteve normative

Republika e Maqedonisë së Veriut është nënshkruese e dokumenteve të rëndësishme ndërkombëtare në bazë të të cilave bazohet i inkluzionit arsimor. Anëtarë të caktuar nga Konventa për të drejtat e fëmijës si dhe dokumente tjera dhe konventa të cilat kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, janë pjesë përbërëse gjegjësisht të shpërndara në nene në Ligjin për arsim fillor (Gazeta zyrtare RMV, nr. 161 nga 5.8.2019) dhe kanë për qëllim ta rregullojnë arsimin inkluziv.

Në bazë të asaj që arsimit inkluziv i merr parasysh nevojat individuale për zhvillim të nxënësve, duke dhënë mundësi të njëjta për realizimin e të drejtave themelore të njeriut për zhvillim dhe arsim kualitativ, në konceptin e arsimit inkluziv<sup>11</sup> janë të dhëna drejtimit për bashkangjitime, zhvillim dhe arsimim në grupet e ardhshme të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore.

(NVA):

- nxënës me pengesa – të cilët kanë dëmtime afatgjate fizike, mentale, intelektuale ose dëm-

time shqisore dhe të cilat në interakcion me barierrat shoqërore të ndryshme mund ta pengojnë pjesëmarrjen e tyre të përgjithshme dhe efektive në shoqëri, në baza të barabarta me tjerët,

- nxënës me çrregullime në sjelljet ose problem emocionale ose me probleme specifike në mësim,
- nxënës të cilët rrjedhin nga hapsira të privuara të pafavorshme socio-ekonomike, kulturore, dhe/ose gjuhësore,
- nxënës me nevoja komplekse – të cilët kanë vështirësi të më shumë shkallëve, çrregullime të më tepër shkallëve, nevoja komplekse shëndetësore dhe nevoja për ndihmë intensive më të madhe dhe përkrahje,
- fëmijë/nxënës me shtetësi të huaj, fëmijë pa shtetësi, fëmijë të arratisur, kërkues të azilit, fëmijë me status të pranuar të të arratisurit, fëmijë nën mbrojtje plotësuese, fëmijë nën mbrojtje të përkohshme të cilët qëndrojnë në shtetin tonë,
- fëmijë/nxënës të cilët nuk ishin të kyçur në mësim, ndërsa janë me moshë të tejkaluar dhe
- fëmijë/nxënës dhe nga kategoritë e prekshme të cilët nga arsytet e ndryshme kërkojnë përkrahje të veçantë dhe kujdes përgjatë procesit edukativo-arsimor.

Koncepti për arsim inkluziv, rregullorë për mënyrën e vlerësimit të nxënësve me pengesa, udhëzim për mënyrën për bashkëpunim mes shkollave fillore me qendrën për resurse, qendrat për përkrahje në mësim dhe shkollat tjera fillore. Është me rëndësi të theksohet se në të gjitha këta dokumente janë të respektuara këta principe udhëheqëse për ndërtim të arsimit inkluziv:

- **qasje në personalitetin e plotë (whole person approach)**, do me thënë se të gjithë fëmijët dhe nxënësit mund të mësojnë, të zhvillohen, të arrijnë dhe të kontribuojnë në bashkësinë dhe më gjerë në shoqërinë.

- **Drejtësi**, ose garancion se të gjithë fëmijët dhe nxënësit kanë qasje deri te përkrahja e domosdoshme, për ta realizuar potencialin e vet për mësim dhe zhvillim.

- **Inkluzioni** është e drejtë e të gjithë fëmijëve dhe nxënësve për përfishirje dhe pjesëmarrje, efektiv dhe plotësisht në kontekstin edukativo-arsimor inkluziv.

<sup>11</sup> <http://mon.gov.mk/stored/document/Koncepcija%20za%20inkluzivno.pdf>

- **Përfshirja e bazuar në tërë shkollën (Whole school approach)**, që do të thotë ndërtimi i kapaciteteve në vetë shkollën për zhvillimin e klimës inkluzive dhe siguri mi i përkrahjes sistematike e kuadrit të tërë-sishëm edukativo-arsimor. Organizimi i procesit edukativo – arsimor sipas masës së nxënësit, gjatë së cilës për llojin e përkrahjes vendoset në individualisht për secilin nxënës në pajtueshmëri me potencialin e tij, kërkesat dhe interesat.
- **Fleksibiliteti** – organizimi fleksibil i planit mësimor, programit mësimor, hapësirës dhe kohës shkollore për të mundësuar procesin edukativo-arsimor nëpërmjet zbatimit të metodave dhe aktiviteteve përkatëse mësimore, për t'iu përgjigjur specifikave dhe llojeve të mësimin për çdo nxënës/nxënëse.
- **Vetëvendosja** – respektimi i pavarësisë personale duke marrë parasysh nevojat, intereset dhe aftësitë e nxënësve, identitetin kulturorë dhe gjuhësor, duke krijuar mundësi për realizimin e të drejtës në pjesëmarrje dhe sjellje të vendimeve.
- **Përgjegjësia dhe autonomia e shkollës** të definojë procesin në të cilin identifikohen barrierat në mësim me të cilat ballafaqohet nxënësi dhe planifikimi i strategjive dhe masave më të ndryshme për tejkalimin e tyre.
- **Arsimtarët kanë përkrahje** për zhvillimin e diturive të tyre, qëndrimeve, shkathtësive, vlerave për ndërtimin e mjediseve mësimdhënësve/mësimnxënëse. Janë të përgatitur të bashkëpunojnë, shkëmbejnë shembuj të suksesshëm nga praktika dhe besojnë se aftësia nuk është fikse dhe se të gjithë nxënësit mund të zhvillohen dhe të mësojnë.
- **Përfshirja e prindërve /kujdestarëve-** kanë të drejtë në pjesëmarrje dhe informime për të gjitha aspektet e procesit edukativo-arsimor të fëmijës së tyre. Përveç relacioneve partnere me prindët/kujdestarët i domosdoëshëm është edhe bashkëpunimi me shoqatat qytetare, organizatat, shoqatat e personave me pengesa, me qëllim të shpërndarjes së resurseve për përparimin e inkuzionit, me theks në përshtatjen dhe shërbimet e kuptueshme.

**Procesi në kontinuitet i monitoringut dhe evaluimit**, nënkupton se shkolla ka të zhvilluar plan për monitoring (përcjelle) dhe evaluim (vlerësim) në të cilin do të jenë qartë të definuar: indikatorët (hyrëse, procesuese dhe dalëse), burimet e verifikimit, korniza kohore (afatet), resurset dhe personat përg-

jegjës.

Në nenin 11, pika 2 nga Ligji për arsimin fillor, arsimimi inkluziv definohet si proces i cili i merr parasysh nevojat e ndryshme individuale për zhvillim të nxënësve, duke u dhënë mundësi të njëjta për realizimin e të drejtave themelore njerëzore për zhvillim të arsimit kualitativ. Arsimi inkluziv bashkangjet ndryshime dhe përshtatje në përmbytjen mësimore, qasja, strukturat dhe strategjitë, për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, me vizion të përbashkët dhe bindje se shteti ka për obligim të sigurojë arsimim për të gjithë fëmijët. Infrastruktura, përkrahja e individualizuar, plani mësimor dhe programi në shkollën fillore, janë në mënyrë të arsyeshme të përshtatura sipas nevojave individuale të nxënësit. Përshtatja e arsyeshme paraqet ndryshim dhe adaptim në kushtet për edukim dhe arsimim në rast të caktuar, e cila nuk shkakton ngarkesë të panevojshme joproporcionale të shkollës, ndërsa është me qëllim sigurim të kënaqësisë ose realizim i të gjitha të drejtave njerëzore dhe liritë e nxënësve me pengesa në baza të barabarta me tjerët.

Në nenin 19 të Ligjit për Arsim fillor parasheh përkrahje të mësimin për nxënësit me pengesa, përgjatë së cilës shkolla fillore siguron: asistent arsimor, asistent personal, përkrahje adekuate profesionale nga qendra për përkrahje të mësimin, ekipi inkluziv dhe teknologjia asistive, sipas rekomandimit të organit profesional për vlerësim dhe në pajtueshmëri me planin arsimor individual ose programës së modifikuar.

**Asistentët arsimor** – marrin pjesë në mësim në mënyra të ndryshme, çdoherë nën supervizionin e arsimtarit, që të përmirësohet procesi i mësimin. Ata mund ta lehtësojnë punën grupore me nxënësit, herë pas here të punojnë në mënyrë individuale me nxënës të caktuar në përforsimin të shkathtësive të tyre, të ndihmojnë në menaxhimin në klasë (menaxhment i disiplinës, motivacion, emocione dhe nevoja të nxënësve). Qëllimi i përkrahjes të cilën e japin asistentët arsimor është përmes bashkëpunimit me arsimtarët dhe përmes zbatimit të metodave të mësimin kooperativ dhe mësimdhënie tu ndihmojnë nxënësve të marrin pjesë në procesin edukativo-arsimor, maksimalisht t'i realizojnë potencialet e tyre dhe të arrijnë pavarësi dhe bashkangjitime sociale në ambientin e shkollës.

**Asistentët personal** – angazhohen si përkrahje të nxënësve me pengesa, në realizimin e aktiviteteve të përditshme. Qëllimi i përkrahjes të cilën e jep asistenti personal është që t'i mundësojë nxënësit me pengesa ndihmë individuale praktike përgjatë plotësimit të nevojave themelore në jetën

e përditshme: lëvizje, mbajtja e higjienës personale, të ushqyerit, veshmbathjes dhe komunikim me të tjerët. Ky lloj i përkrahjes mundëson që nxënësi të arrijë nivel më të lartë të pavarësisë dhe funksionalitet, si bazë për bashkangjitime më të lehtë në procesin edukativo-arsimor dhe aktiviteteve në bashkësinë.

Mënyrën e kërkesës të asistentit arsimor/asistent personal, mënyra e selektimit dhe zgjedhja e asistentit arsimor/ asistentit personal, si dhe programën për trajnim të asistentit arsimor /asistentit personal i vërteton ministri, me propozim të Byrosë.

**Shkollat fillore me qendër resurcesh** – me zhvillimin e inkluzionit, shkollat e veçanta transformohen në shkolla me qendër resurcesh dhe bëhen nacionale, përkatësisht qendra regjionale të cilat do t'i ofrojnë resurset profesionale, materiale dhe hapsinore për nxënësit me pengesa, familjet e tyre dhe kuadrin edukativo-arsimor në shkolla. Ata do të bëjnë trajtim individual dhe rehabilitim, do ta sigurojnë asistencën arsimore dhe personale, do të marrin pjesë edhe në realizimin e një pjese të programës së modifikuar për nxënësit me nevoja komplekse, në pajtim me rekomandim të organit profesional për vlerësim funksional.

**Qendrat për përkrahje të mësimi** – me zhvillimin e inkluzionit, paralelet e veçanta pranë shkollave transformohen në qendra për përkrahje të mësimi dhe do t'i ofrojnë resurset e tyre profesionale, materiale dhe hapsinore për nxënësit me pengesa, familjet e tyre dhe kuadrin edukativo-arsimor në shkolla. Ata do të realizojnë trajtim individual dhe rehabilitim dhe do të marrin pjesë në realizimin e pjesës së modifikuar të programit për nxënësit me nevoja komplekse, në pajtim me rekomandimet e organit profesional për vlerësim funksional.

Mësimi për nxënësit me pengesa në shkollat fillore realizohet sipas **planit individual arsimor ose programit të modifikuar mësimor**. Plani individual arsimor bashkangjet adaptim të rezultateve nga mësimi të programës mësimore, kyçje të aktiviteteve dhe metodave të cilat mundësojnë arritje të rezultateve nga mësimi, ndërsa, përsëri, modifikimi i programës mësimor, dedikuar për nxënësit me nevoja komplekse, përgatitet për çdo periudhë edukativo-arsimore në arsimin fillor dhe me ate përcaktohen rezultatet nga mësimi, duke u bazuar në kompetencat me të cilat duhet të fitohen dhe të zhvillojnë pavarësi, zhvillim personal dhe marrëdhënie sociale.

Në Nenin 24 nga Konventa e OKB për të drejtat e

personave me invaliditet<sup>12</sup>, vendet nënshkruese e pranojnë të drejtën për arsim të këtyre personave pa diskriminim dhe në bazë të mundësive të barabarta, sigurojnë arsimim të të gjitha niveleve dhe mësim gjatë gjithë jetës. Përgjatë realizimit të kësaj të drejte, vendet nënshkruese të kësaj Konvente, mes tjerash, sigurojnë personat me invaliditet që ta fitojnë përkrahjen e nevojshme në kuadër të sistemit të përgjithshëm arsimor që të thjeshtësohet arsimimi i tyre efikas. Neni 26 nga deklarata Univerzale për të drejtat e njeriut<sup>13</sup> e përmban parimin se çdokush ka të drejtë për arsim, ndërsa prindërit/kujdestarët kanë të drejtën primare që ta zgjedhin llojin e arsimimit për fëmijët e tyre. Bashkangjiteten e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në sistemin e rregullt arsimor nënkupton inkluzion të plotë në punën dhe jetën e përgjithshme në shkollë.

Ky proces preferon mundësim të më shumë kushteve për inkluzion të sukseshëm, mes të cilave edhe mundësinë për sigurim të qasjes ekipore përgjatë përballimit me sfidat, largimin e të gjitha formave të diskriminimit dhe barrierat të cilat e pengojnë të drejtën për arsimim inkluziv e kualitativ.

Për atë qëllim, në pajtim me Nenin 16 pika (1) nga ligji për shkolla fillore, në shkollën fillore drejtori formon ekip inkluziv shkollor, i cili kujdeset për politikën inkluzive dhe praktikën në nivel të të gjithë shkollës dhe ekip inkluziv për nxënësi i cili punon sipas planit individual arsimor (në tekstin e mëtejshëm: (PIA) ose sipas programës së modifikuar mësimore nga Neni 30 të këtij ligji.

Në dokumentin „Indikatorët për kualitet të punës nëpër shkolla“<sup>14</sup>, të Inspektoratit Shtetëror të Arsimit, ka më tepër indikatorë të cilët kanë të bëjnë me arsimin inkluziv.

Në programën vjetore për punë të shkollës në kapitullin 8 „Programet dhe organizimin e punës në shkollën fillore“ shkollat e planifikojnë edhe punën me nxënësi me nevoja të veçanta.

<sup>12</sup> <http://www.mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/Konvencija%20za%20pravata%20na%20licata%20so%20invalidnost.pdf>

<sup>13</sup> Deklarata univerzale për të drejtat e njeriut (Gazeta zyrtare e RM nr. 57/93)

<sup>14</sup> Indikatorët për kualitetin e punës së shkollave. (2019). Inspektorati shtetëror i arsimit

Në kompetencat themelore profesionale të arsimtarëve në shkollat fillore dhe të mesme<sup>15</sup> në lëminë: Inkluzioni social dhe arsimor është dhënë përshkrim i kompetencave që kanë të bëjnë me njohuritë e arsimtarit për koncepte të ndryshme dhe modele për mësim inkluziv, konventat për të drejtat e fëmijëve dhe për antidiskriminimin, lloje të ndryshme të nxënësve të cilëve u është e nevojshme përkrahja plotësuese në arsim: nevojat e veçanta arsimore, vështirësitë në mësim dhe mungesa e shkaqet socio-ekonomike, si dhe kuptimi i faktorëve kulturor dhe social dhe mënyrën në të cilët ndikojnë ndaj arsimit edhe ndaj kohezionit social.

Në lidhje me aftësitë profesionale dhe shkathtësitë që është e nevojshme që t'i posedojë arsimtari janë të vendosura këto: pjesëmarrje në procesin e identifikimit të vevojave specifike arsimore bashkërishtë me shërbimin profesional dhe shfrytëzimi i metodave të ndryshme për diferencim dhe individualizim të mësimin, pjesëmarrje në ekipet për përpunimin e planeve individuale arsimore, punë në ekipet inkluzive shkollore, dhënia e mundësive të barabarta për çdo fëmijë dhe familje të marrin pjesë në aktivitetet mësimore dhe jashtëmësimore, pa marr parasyshë aftësitë psiko-fizike, gjinia, prejardhja etnike, kultura, gjuhën amtare, religjioni, strukturën familjare, statusin ekonomik dhe social, përgatitje të nxënësve për pranim të fëmijëve nga grupet e prekura dhe fëmijë me nevoja të veçanta arsimore.

Edhe në kompetencat themelore dhe profesionale dhe standardet për bashkëpunëtor profesional<sup>16</sup> janë kompetenca të përmbajtura për arsim inkluziv në lëmi të ndryshme të punës të bashkëpunëtorëve profesional, ndërsa barabarësia, drejtësia inkluzive dhe sociale janë pjesë nga vlerat nga të cilat udhëhiqen në punën e tyre profesionale.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut rregullativa e procesit të inkluzionit të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore është e bazuar në përvojat pozitive botërore, të adaptuara me kontekstin tonë nacional. Në atë drejtim, ndërsa në favor të ringjalljes në demokratizimin e përgjithshëm dhe humanizimin, edhe më tepër theksohet përpjekja

e përgjithshme „arsimim të drejtë për të gjithë“, përkatësisht zbatimi i së drejtës fundamentale të arsimit.

Korniza për aksion të arsimit 2030 është miratuar nga bashkësia globale për arsim<sup>17</sup>, që të përmirësohet përparimi drejt qëllimeve për zhvillim të përmbajtur zhvillim në Qëllim 4: Të sigurohet arsimim inkluziv, të drejtë dhe kualitativ dhe të promovohen mundësitë për mësim gjatë gjithë jetës për të gjithë e thekson nevojën për zgjidhjen të të gjitha formave të përjashtimit dhe marginalizimit. Më konkretisht, thirret në zgjidhjen e pabarazimeve të lidhura me qasjen, pjesëmarrjen dhe proceset të mësimin dhe rezultatet, duke patur kujdes në barabarësinë gjinore. Qeveria e Maqedonisë së Veriut e pranoi Agjendën 2030 si „kornizë univertzale për përforcimin të aksionit kolektiv drejt qëllimeve të përbashkëta dhe sfidave“, gjatë së cilës „zvogëlimi i pabarazisë“ dhe „askush të mos jetë i anashkaluar“ janë principe kyçe në bazën e aktiviteteve të tyre. Njëra nga qëllimet kyçe zhvillimore e përcaktuar nga ana e Këshillit nacional për zhvillim të qëndrueshëm është pikërisht qëllimi për zhvillim të qëndrueshëm: Arsim kualitativ (<https://epi.org.mk/wp-content/uploads/2020/07/Maqedonia-Veriore-DNP.pdf>)<sup>18</sup>.

<sup>15</sup> Rregullore për kompetencat themelore profesionale të arsimtarëve të shkollave fillore dhe të mesme, sipas fushave, [http://mon.gov.mk/stored/document/06\\_Pravilnik-za-osnovni-profesionalni-kompetencii-zanastavnici\\_18\\_02\\_20....pdf](http://mon.gov.mk/stored/document/06_Pravilnik-za-osnovni-profesionalni-kompetencii-zanastavnici_18_02_20....pdf)

<sup>16</sup> Rregullore për kompetencat themelore profesionale sipas fushave të bashkëpunëtorit profesional në shkollat fillore dhe të mesme, [http://mon.gov.mk/stored/document/07\\_Pravilnik-za-osnovni\\_kompetencii\\_strucen\\_sorabotnik\\_13\\_02\\_2020.pdf](http://mon.gov.mk/stored/document/07_Pravilnik-za-osnovni_kompetencii_strucen_sorabotnik_13_02_2020.pdf)

<sup>17</sup> United Nations. 2015. Transforming our world: the 2030 Agenda for Sustainable Development. Достапно на: <https://sustainabledevelopment.un.org/post2015/transformingourworld>

<sup>18</sup> Pasqyrë nacionale vullnetare: Qëllimet për zhvillim të qëndrueshëm. 2020. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut


### 3. Ekipi shkollor inkluziv

Formimi i ekipeve inkluzive është i rregulluar në Ligjin për arsim fillor. Në shkollën fillore drejtori formon ekipin inkluziv shkollor (EISH) dhe ekipin inkluziv për nxënësin (EIN) të cilat janë të lidhura ndërmjet vehtes në dy mënyra: EISH i mendon dhe i realizon aktivitetet në nivel të tërë shkollës dhe kujdeset që ata të përshtaten dhe të zbatohen në punë, ndërsa EIN në fokusin e punës së vet e kanë nxënësin konkret, përgatitjen dhe realizimin e PIA ose programën e modifikuar. Anëtar i EISH mundet të jetë edhe anëtar i caktuar i EIN ose të jetë përgjegjës për lidhjen me EIN konkrete.

Gjatë formulimit të rekomandimeve të cilat janë dhënë më tutje në udhëzuesin janë shfrytëzuar, përvoja nga puna e ekipeve inkluzive në pilot-shkollat në programën Arsimit inkluziv në shkollat fillore, përvojat nga pilotimi i versionit të parë të Udhëzuesit, përvojat nga realizimi i trajnimeve për përforcimin e kapaciteteve të shkollave për arsim inkluziv, si dhe përvojat e vendeve të tjera. Protokollet të përshkruara në këtë Udhëzues kanë të bëjnë fillimisht me punën e EISH.

**Ekipi shkollor inkluziv** është risi në shkollat tona në vitet e fundit, megjithatë ekipet shkollore për lëmi të ndryshme nuk janë të reja, si edhe lëmia e inkluzionit në baza të ndryshme nuk është e re në shkollat bashkëkohore. Edhe përveç drejtimeve për punën në **EISH-it** të cilët janë dhënë në këtë Udhëzues, shkollat, po qe se mendojnë se është e nevojshme, mund të përgatisin akte interne për rregullimin e punës së **EISH**.

Roli i ekipit inkluziv shkollor është të punoj në mënyrë sistematike në pyetjet në lidhje me inkluzionin dhe të vendosjes së procedurave për zgjidhjen e sfidave të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në shkollë, të cilat do tu jenë të njohura të gjithëve në shkollë. Përmbajtja konkrete e punës për çdo ekip shkollor inkluziv do të varet nga specifikat e shkollës. Ekipi inkluziv shkollor ngushtë bashkëpunon me ekipe tjera/komisione në shkollë, puna e të cilëve është, në njëfarë mënyre, është e lidhur me inkluzionin (për shembull me ekipin për integrim etnik, vetëevaluimin, planifikimi zhvillimor e të ngjashme)



Ekipi inkluziv shkollor është me mandat nga tre vite shkollore dhe është i përbërë nga shtatë anëtarë edhe ata: pedagog, përkatësisht psikolog, përkatësisht punëtor social, dy arsimtarë nga ana e të punësuarëve në shkollë, dy prindër/kujdestarë, edukatorë special dhe rehabilitues dhe drejtori i shkollës. Po qe se shkolla nuk ka bashkëpunëtor profesional nga profile të përcaktuar përcaktohet person nga shkollat me qendrën e resurseve ose qendrat për përkrahje të mësimi. Gjatë zgjedhjes së anëtarëve të **EISH** të cilët nuk janë në përbërje të përhershme duhet të merren parasysh qendrimit e tyre pozitive në lidhje me inkluzionin dhe kompetencat për praktikat inkluzive. Ashtu do të sigurohet **EISH** të jetë senzitiv për të gjitha pyetjet në lidhje me inkluzionin, kompetitiv dhe i përgatitur për bashkëpunim me arsimtarët dhe në kohë të reagojë në sfidat me të cilat ballafaqohen nxënësit dhe bashkërisht të gjejnë zgjidhje.

Organizimi i punës së **EISH** është e rëndësishme për efikasitetin e punës. Në atë drejtim **EISH** duhet të vendos procedura për punën e vet, p.sh. cilat aktivitete i ka në baza të rregullta, si deri te ekipi vijnë informacionet për nxënësit me **NVA**, si komunikohet me udhëheqësinë e shkollës dhe me kolegët (mënyrat formale dhe joformale, komunikime elektronike, komunikim dhe bashkëpunim me organin profesional për vlerësim të nxënësit sipas klasifikimit ndërkombëtar të funksionimit (**KNF**),<sup>19</sup> bashkëpunim dhe komunikim dhe bashkëpunim me shkollat fillor, me qendrën e resurseve, me qendrat për përkrahje në mësim e të ngjashme) **EISH** duhet të ketë të përcaktuar vend për mbledhje dhe kohë të përcaktuar për mbledhje të rregullta.

Për punë më efektive **EISH** duhet të përcaktojë udhëheqës/ kordinator (i cili do t'i konvokojë dhe organizojë mbledhjet), verbalist (i cili do të mbajë shënime dhe evidencë tjetër nga takimet), ndërsa anëtarët të cilët nuk janë në përbërjen e përhershme është mirë që të jenë të specializuar/ të përgjegjshëm për pyetje të caktuara nga lëmia e inkluzionit (sh. puna me nxënës me pengesa, me problem në sjelljet e të ngjashme.)

Të punësuarit në shkollë duhet që me kohë të jenë të njoftuar me informacionet për mënyrën e punës së **EISH** të cilat janë relevante për ata, me të cilat do të përmirësohet bashkëpunimi.

**Ekipi inkluziv për nxënës**, është për periudhën deri në përfundimin e shkollës fillore të nxënësit dhe është pjesë përbërëse e: arsimtarëve të nxënësit, prindit/kujdestarit, pedagogut, përkatësisht psikologut, përkatësisht punëtorit social në shkollë dhe edukatorit special dhe rehabilituesit. Po qe se shkolla nuk ka bashkëpunëtor profesional nga profile të caktuara përcaktohet person nga shkollat me qendër resurseve ose qendrat për përkrahje të mësimi. Në këtë ekip, sipas nevojës, mund të bashkëngjiten edhe persona tjerë të cilët i japin përkrahje nxënësit (mjek, lloj tjetër të bashkëpunëtorit profesional ose rehabilitues me të cilin nxënësi punon jashtë shkollës dhe të ngjashme), si asistent arsimor ose asistent personal, për derisa i njejtë është popozuar nga organi profesional për vlerësim funksional dhe punë me nxënësin.

<sup>19</sup> Klasifikimi ndërkombëtar i funksionaliteteve, pengesave dhe shëndetit - KNF. [https://www.unicef.org/northmacedonia/sites/unicef.org.northmacedonia/files/201901/MK\\_SP\\_CWD\\_ICF\\_MK.pdf](https://www.unicef.org/northmacedonia/sites/unicef.org.northmacedonia/files/201901/MK_SP_CWD_ICF_MK.pdf)



## PJESA II

# PROTOKOLET DHE INSTRUMENTET PËR PUNËN E EKIPIT INKLUZIV SHKOLLOR

### Fusha 1. Përfshirja dhe kyçja e nxënësve

Të sigurohet kyçja dhe përfshirja e nxënësve në aktivitetet mësimore dhe jashtëmësimore është bazë e arsimit inkluziv.

Në pajtim me rregullativën ligjore dhe politikat inkluzive të shkollës EISH duhet të bashkangjitet në vënien e mekanizmave dhe në ndërmarrjen e aktiviteteve që do të sigurojnë përfshirje të të gjithë obliguesve shkollor. Ata kanë të bëjnë me regjistrimin e nxënësve në klasë të parë, mbajtja e nxënësve në shkollë gjatë gjithë arsimit fillor, sigurimi i kalimit adekuat në shkollë tjetër ose pranim të nxënësve nga ndonjë shkollë tjetër, si dhe në përkrahje në vazhdimin e shkollimit në shkollë të mesme.

Kushti i rradhës që të jetë arsimiti inkluziv, është sigurimi i kyçjes dhe pjesëmarrjes së arsimtarëve në aktivitetet mësimore dhe jashtëmësimore sipas nevojave, mundësive dhe interesave të nxënësve. EISH përgatit protokole për sigurimin, kyçjen fillestare dhe përcjelljen e pjesëmarrjes së nxënësve në të gjitha aktivitetet në të cilat janë kyçur.

#### 1.1. Përfshirja e nxënësve

Ekipi inkluziv në shkollë merr pjesë në përpilimin, evidentimin e aktiviteteve të cilat duhet të ndërmerren që të sigurohet përfshirja maksimale e nxënësve nga rajoni dhe pranimi i nxënësve edhe nga rajone tjera nëse ka kushte për ate. Bashkë me anëtarët për komisione dhe grupet punuese shkollore (si p.sh. komisioni për regjistrim të nxënësve) dhe me bashkëpunëtorët profesional i përpunon procedurat të cilat realizohen dhe formularët të cilat mbahen për evidencë (shtojca 1/1).

### 1. Protokoli për regjistrim të nxënësve në klasën e I

Përfaqësues nga EISH janë anëtarë të komisionit për regjistrim në kl. të parë I dhe marrin pjesë në detektimin e përgatitjes për të nisur në shkollë, si dhe në identifikimin e nxënësve me NVA (shtojcat: 1/4-a, 1/4-b, 1/5, 4/9).

1.1. Në intervistën/takim me prindër/ kujdestarin me shërbimin profesional ose me komisionin për regjistrim të nxënësve, grumbullohen të dhëna relevante për zhvillimin e fëmijës dhe përgatitje së tij për nisje në shkollë. (shtojcat 1/2, 1/3-a, 1/3-b). Gjatë regjistrimit të fëmijut me pengesa në klasë të parë prindi/kujdestari është e nevojshme që të ofrojë edhe mendim/profil funksional nga organi profesional për vlerësim funksional dhe ta sjell dosien për fëmijun nga kopshti (po qe se ka ndjekur kopsht). Përdërisa komisioni shkollor për regjistrim të fëmijëve në klasë të parë vlerëson se fëmiju ka vështirësi të caktuar funksionale, ndërsa prindi/kujdestari nuk ofron mendim/profil funksional nga organi profesional për vlerësim funksional e drejton prindin/kujdestarin tek organi profesional për vlerësim, me qëllim që të fitohen informata relevante dhe drejtime për masat e nevojshme për përkrahje.

1.2 EISH në bashkëpunim me bashkëpunëtorët profesional ndërmerr aktivitete të ndryshme (vizita të familjeve, kampanja, bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, bashkësia vendore dhe të tjera) t'i përfshijë të gjithë nxënësit nga rajoni i vetë. Për ata mbahen shënime anekdoteske për aktivitetet e ndërmarra për regjistrim të nxënësit të parregjistruar në shkollën fillore.

1.3. Për nxënësit të cilët nuk janë të regjistruar në shkollë, ndërsa sipas rajonizimit i takojnë rajonit të shkollës, bashkëpunëtorët profesional mbledhin të dhëna se a janë dhe

në cilën shkollë janë regjistruar, përmes informacioneve kthyesë nga prindërit/kujdestarët përmes ftesave të dërguara paraprake, lajmërimeve me telefon ose vizita të shtëpiave. Sipas nevojës kërkohen informacione nga institucionet përgjegjëse. Përpjekje të veçanta bëhen që të gjenden nxënësit të cilët në vitin paraprak nuk janë regjistruar në klasë të parë ose e kanë braktisur shkollën gjatë klasës së parë. Prindërve/kujdestarëve të këtyre fëmijëve u japin përkrahje që t'i tejkalojnë pengesat për regjistrim dhe t'i regjistrojnë fëmijët. Në klasë të parë regjistrohen edhe fëmijë pa dokumente/shtetësi edhe fëmijët emigrantë në moshë deri më tetë vjet, përdërisa sipas rajonizimit i takojnë rajonit të shkollës.

- 1.4 Komisioni për rregjistrim përgatit Raport për rregjistrimin e nxënësve në klasë të parë I, i cili duhet të përmbajë: Numër të obliguesve shkollor në rajonin e shkollës, të dhëna për rregjistrimin e nxënësve sipas gjinisë, përkatësisë etnike, arsimimit e prindërve dhe të ngjashme. Anëtarët e komisionit nga EISH kujdesen për pjesën e raportit i cili ka të bëjë me nxënësit me NVA.

## 2. Protokol për formimin e paraleleve nga klasa e parë

- 2.1 EISH merr pjesë në përgatitjen e rregullave për formimin e paraleleve gjatë së cilës i kushtohet kujdes inkluzionit për të gjithë nxënësit. Rregullat i shqyrton dhe i pranon këshilli i arsimtarëve.
- 2.2 Anëtarë të EISH detyrimisht janë të kyçur në formimin e paraleleve në kl. e parë I. Ata në veçanti kanë kujdes ndaj nxënësve me NVA që të jenë të kyçur sipas rregullativës normative dhe rekomandimeve pedagogjiko-psikologjike.

8.	<b>Përkrahja e arsimtarëve në identifikimin (detektimin) të nevojave mësimore të fëmijëve</b>	Arsimtarët ta ndërrojnë paradigmen nga identifikimi i (nevojat e veçanta" drejt identifikimit të nevojave për mësim të fëmijëve dhe drejt qasje, i cili fokusohet në identifikimin (detektimin ) e vështirësive gjatë mësimin	Takime konsultative	EISH	*Është rritur numri i arsimtarëve të cilët dinë të identifikojnë dhe të ndihmojnë në pengesat specifike në mësimin e nxënësve	Gjatë vitit shkollor
9.	<b>Përkrahje nga nxënësit – punëtori me anëtarë të bashkësisë së shkollës</b>	*Të sigurohet përkrahje e nxënësve për nxënësit me NVA	Punëtori	EISH Arsimtarë	*Është rritur numri i nxënësve të cilët në mësim dhe jashtë saj u ndihmojnë nxënësve me vështirësi në mësim;	Gjatë vitit shkollor
10.	<b>Përcelje dhe identifikim të fëmijëve të cilët kanë nevojë nga mësimi plotësues</b>	*Të shfrytëzohet vërtetimi diagnostik në fillim të vitit shkollor *Nxënësit të vlerësohen në mënyrë formative	Përpunimi i drejtimeve dhe instrumenteve; Për mbajtjen e shënimeve, për mbledhjen e punimeve, eventualisht edhe të çek listave e të tjera.	EISH Arsimtarë	*Identifikimi në kohë të nxënësve me vështirësi gjatë mësimnxënies së materialit mësimor në mësimin e rregullt; *Është rritur numri i nxënësve të cilët me sukses i përballojnë përmbajtjet nga përshtatja e punës mësimore drejt nevojave të tyre individuale	Gjatë vitit shkollor

11.	<b>Takime joformale me arsimtarët dhe kuadrin tjetër dhe biseda për dis pyetje ose vështirësi</b>	*Të rritet bashkëpunimi e kudrit shkollor dhe të përgatitjen aktivitetet të përbashkëta individuale	Këmbimi ideve, propozimeve, mendimeve, konsultimeve	EISH	Është rritur numri i arsimtarëve të cilët kanë fituar përkrahje nga EISH.	Gjatë vitit shkollor
12.	<b>Takime dhe konsultime me persona profesional jashtë shkollës</b>	*Të fitohet ndihma profesionale plotësuese dhe përkrahja ; *Të këmbehen përvojat dhe idetë, si dhe bashkëpunimi në aktivitetet nga përmbajtje të caktuara	Takime, marrëveshje, konsultime dhe të tjera.;	EISH	*përparimi i arsimit inkluziv dhe i procesit edukativo-arsimor	Gjatë vitit shkollor
13.	<b>Raport për punën e EISH</b>	Të mbledhet (sumohet) realizimi i aktiviteteve dhe efektet nga puna e EISH edhe i arsimit inkluziv në shkollë.	*Vetëevaluimi i inkluzionit të shkollës dhe të punës së EISH *Finalizimi i portfolios inkluzive shkollore për vitin shkollor *Sumimi i aktiviteteve të EISH *Refleksioni i punës së EISH	EISH	*Është dokumentuar puna e EISH *Është bërë analiza e punës së EISH *Janë formuluar propozimet për punë për vitin e ardhshëm	Qershor Viti _____

Programi është i hapur edhe gjatë vitit shkollor dhe mund të jenë të kyçur edhe aktivitetet të tjera, po qe se ka nevojë.

## Shtojca 2/2. Shembull për PLANIN AKSIONAR TË EKIPIT PËR INKLUZION TË NXËNËSVE ME NEVOJA TË VEÇANTA ARSIMORE

## PLANI AKSIONAR

Detyra	Aktivitetet	Koha e realizimit	Bartës	Mënyra e realizimit (resurset)	Instrumentet	Rezultatet e pritura	Personi përgjegjës përcjellje	Buxheti i nevojshëm
Operacionalizimi i politikës për punë me nxënës me nevoja të veçanta arsimore dhe vështirësive emocionale	Përpunimi i programit vjetor për punë dhe planit aksional	Gusht	EISH	Drejtimet për punimin e programës vjetore për punën e shkollës		Në programet për punë janë bashkangjitur edhe aktivitetet për arsimin inkluziv	Anëtar nga EISH	
Identifikimi i nxënësve me PIA	Bisedë me arsimtarë dhe kujdestar, identifikimi i nxënësve me NVA të regjistruar në klasë të parë,	Shtatori	Arsimtarë EISH	Dialog, procedura për përcjelljen dhe përpunimin e PIA, Qendra këshilldhënëse për fëmijë dhe prindër SOS Fshati i fëmijëve, punëtorë social patrullues		Evidentimi i nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe ndërtimi i strategjisë së veçantë për punë me ata		
Njohja e arsimtarëve lëndor nga klasa e gjashtë VI me nxënësit me NVA të cilët kalojnë nga mësimi klasor, në lëndor	Shkëmbimi i përvojave mes arsimtarëve klasorë dhe lëndorë me punën me këta nxënës (me dosie nxënësish)	Shtatori	Bashkëpunëtorë profesional, arsimtarë nga klasa a pestë V. Arsimtarë lëndor nga klasa e gjashtë VI.	Diskutime	Listë evidentuese për përcjellje, dosie e nxënësit	Pranim adekuat të nxënësve me PIA të cilët kalojnë në klasën e gjashtë VI.		
Përgatitja e planit individual arsimor	*Revidimi i PIA (forma, përmbajtja...) *Përgatitja e PIA (planifikim afatgjatë të mesëm dhe ditë të qëllimeve të diferencuara) *Përgatitja e PIA për nxënësit me PN nga klasa e parë	Në kointinuitet	Arsimtarë, bashkëpunëtorë profesional, prindër	*Programi vjetor për klasën adekuate *Gjetjet dhe mendime nga qendra DFZ, Qendra për dëgjim, të folur dhe zë, klinika për sëmundje të fëmijëve, Klinika për psikiatri	Formularë për PIA	Përshtatje e sukseshme e programit mësimor për nxënësit me PN.		

Përkrahja në kontinuitet e nxënësve me Pengea PN	*Biseda konsultative të bashkëpunëtorëve profesional me arsimtarët klasor, kujdestarë dhe prindër *Puna konsultativo-këshilluese me nxënësit me vështirësi emocionale dhe nevoja të veçanta	Gjatë vitit shkollor	Bashkëpunëtorë profesional, arsimtarë klasor, kujdestarë klasash, prindër dhe nxënës	Punë konsultative këshilldhënëse, Qendra këshilldhënëse për fëmijë dhe prindër SOS Fshat fëmijësh, punëtorë social dhe patrullues QPS	Dosie e nxënësit me PN	*Përmirësimi i të arriturave *Kështu në jetën e klasës, shkollë dhe bashkësinë vendore *Përforcimi i shkathësive dhe kapaciteteve prindore	
Përcjellja e aktiviteteve të të arriturave të nxënësve me NVA	*Evidentimi për suksesin rregullshëm dhe sjelljen e nxënësve me NVA *Revidimi i PIA	tremujor rrjedhës	Ekip për zbulim dhe kujdes për nxënësit me NVA, bashkëpunëtor profesional, arsimtarë klasorë, kujdestarë klasash	Lista e evidentuese për vlerësim	Listë evidentuese për përcjellje të nxënësve në mes PIA	*Vlerësimi i të arriturave *Kyçja e këtyre nxënësve në punë grupore dhe aktivitetet e lira të nxënësve	
Sigurimi i përkrahjes nga nxënësit	Bisedat këshilluese-konsultative me arsimtarët klasor dhe kujdestarë me klasën, bashkësinë e nxënësve, prindërit	Gjatë vitit shkollor	Bashkëpunëtor profesional, arsimtarë klasorë, kujdestarë klasash, arsimtarë lëndorë, prindër dhe nxënës	Punë këshilluese-këshilldhënëse, Qendra këshilluese për fëmijë dhe prindër SOS, fshat fëmijësh punëtorë social patrullues, QPS	Dosie e nxënësit me PN	Përmirësimi i të arriturave në socializimin e nxënësve me PIA	
Përmirësimi i gjendjes emocionale dhe sociale të nxënësve me NVA	*Biseda me nxënës*Biseda këshilluese me prindërit në mbledhjet prindore dhe takimet individuale *Testet	nëntori	Bashkëpunëtor profesional, arsimtarë klasorë, kujdestarë klasash, arsimtarë lëndorë, prindër.	Punë konsultative këshilluese	Social test (Moreno), Hanesstest	Zhvillimi i vetëbesimit dhe vetërespektit të këta nxënës	
Përmirësimi i praktikës inkluzive	Puna instruktive me arsimtarët	Gjatë vitit shkollor	Bashkëpunëtorë profesional, arsimtarë	Punë konsultative këshilluese		Arritja e qëllimeve të planifikuara në procesin edukativo-arsimor të fëmijëve me nevoja të veçanta.	

**Shtojca 2/3-a. PLANI PËR ORË MËSIMORE**

## PLANI PËR ORË MËSIMORE

për \_\_\_\_\_ në klasën e \_\_\_\_\_

Tema nr. \_\_\_\_\_ ora nr. \_\_\_\_\_

Njësia mësimore: \_\_\_\_\_

Qëllimet	
Të priturat/rezultatet	
Mjetet mësimore dhe materialet	
Rrjedha e orës (aktivitetet për secilën pjesë të orës me format dhe teknikat)	
Korelacioni me:	
Kriteret për notim, mënyrat e ndjekjes dhe notimi i të arriturave dhe përparimi i nxënësve	
Detyrë shtëpie	
<b>Specifikat për nxënësin/nxënësen me PIA:</b> Rezultatet e pritura: Aktivitetet: Mjete dhe procedura për vlerësim:	
Refleksion:	

**Shtojca 2/3-b. PLANI OPERATIV PËR ORË MËSIMORE**

PLANI OPERATIV PËR ORË MËSIMORE

			Njësia mësimore:		Data:	
Koha	Qëllimet mësimore	Kriteret për sukses	Aktivitetet		Resurset	Fakte për të ariturat
			Përshkrimi	F/G/Ç/I		
<b>Specifikat për nxënësin/nxënësen me PIA</b>						
Koha	Qëllimet mësimore	Kriteret për sukses	Përshkrimi	F/G/Ç/I	Resurset	Fakte për të ariturat
Organizimi: Detajet për diferencim / grupe / roli i të moshuarit (lidhur me aktivitetet)				Vërejtje / mundësi për zgjerimi / thjeshtësimi i detyrave të shtëpisë		

**Shtojca 2/4. PASQYRA PËR PLANIFIKIMIN E DIFERENCIMIT**

**Pasqyrë sumative nga vëzhgimet e përgatitjeve ditore të arsimtarëve për diferencim (të qëllimeve, të priturve dhe aktivitetetve)**

Në periudhë nga \_\_\_ deri \_\_\_

Legjenda:

- rregullisht planifikon (në mbi 70% nga planifikimet e kontrolluara)
- kohë pas kohe planifikon (në 40% - 70% nga planifikimet e kontrolluara)
- rrallë planifikon (në më pak se 40% nga planifikimet e kontrolluara)

<b>Nr.r.</b>	<b>Arsimtari</b>	<b>Kl.</b>	<b>Numri i planifikimeve ditore të kontrolluara*</b>	<b>Qëllime të diferencuara (për nxënësit me PIA)</b>	<b>Të pritura të diferencuara</b>	<b>Aktivitete të diferencuara</b>

\* Vërejtje: Duhet të kontrollohen më së paku 10 përgatitje ditore të zgjedhura rastësisht

## Shtojca 2/5 DISA DREJTIME PËR DIFERENCIM

Diferencimi është përshtatje të mësimit dhe mësimin ndaj nevojave dhe mundësitë e nxënësve. Ai është proces me të cilin planifikohen aktivitetet në lidhje me qëllimet e programit mësimor, metodat e mësim-it dhe aktivitetet për mësim për t'u plotësuar nevojat e çdo nxënësi individualisht. Me atë sigurojmë që detyra të jetë adekuate për nevojat individuale të nxënësve, duke i kyçur edhe nxënësit me PIA.

### Pse është i nevojshëm diferencimi?

- Puna edukativo-arsimore e arsimtarit dhe të mësuarit e nxënësve janë efektive atëherë kur janë të përshtatura sipas nevojave të nxënësve.
- Diferencimi jep mundësi për sukses të çdo fëmije dhe mundëson që të gjithë fëmijët të jenë aktiv.

Gjatë asaj duhet patur kujdes për nxënësit të sigurohet:

- Pavarësi në kryerjen e detyrave;
- Sigurimi i burimeve të nevojshme, mjete, materiale për punë;
- Parashtrimi i kërkesave të cilat bashkëveprojnë me interesat dhe aftësitë e nxënësve;
- Planifikimi / sugurimi i kohës së mjaftueshme që t'u përkushtohet të gjitha grupeve;
- Dozimi optimal në detyra (të mos jenë shumë të rënda/shumë të lehta)

### Diferencimi është i bazuar në diagnozë

- Arsimtari patjetër të dijë se kur do të fillojë, me cilin do të punojë;
- Gjendja fillestare është pjesë nga “hyrja” (inputi) në arsim dhe nga ajo varet produkti i ardhshëm;
- Diagnostifikimi është fillimi (hyrje) në nxitjen e procesit të zhvillimit të nxënësit dhe në krijimin e kushteve për ate dhe është bazë për prognozimin të mundësive dhe për planifikimin të punës.

Çfarë duhet të dihet për nxënësin? (Çfarë të diagnostifikohet?)

- Zhvillimi kognitiv (paranjohuri në kuptim më të gjërë të fjalës);
- Zhvillim të folurit dhe gjuhës;
- Aspekti socializues i zhvillimit;
- Zhvillimi emocional;
- Zhvillimi fizik.

Te të gjitha komponentat përcillen dhe njihen:

- Rezultatet, gjendja (çfarë di fëmija)
- Proceset, aktivitetet (si rrjedhin proceset, aktivitetet)



Diagnoza mund të bëhet me ndihmën e procedurave të ndryshme teknike:

- indirekt (informata nga burime të tjera):
  - Informata nga prindërit e nxënësit
  - Informata nga pedagogu i shkollës/psikologu
  - Informata nga arsimtar tjetër, edukator në kopsht, kolegë nga mësimi klasor ose qëndrim ditor
  - Informata nga drejtori ose subjekte tjera
- direkt mbledhja e informacioneve:
  - Vëzhgimi
  - Çek lista ose fleta evidentuese
  - Shkallë të vlerësimit
  - Vlerësimi i krijimeve të gatshme (punime të nxënësit)
  - Biseda

### **Strategjitë për diferencim**

Gjatë diferencimit mund të shfrytëzohen strategji të ndryshme si për shembull:

- Çdo nxënës punon në detyrën e vetë me tempo të vetë;
- Ligjërohet në nivelin e mesëm (materiale të njejta, pyetje, udhëzime) për të gjithë nxënësit, por më të aftit marrin detyrë më të komplikuar, ndërsa ata që kanë vështirësi, marrin ndihmë plotësuese;
- Ndarja e klasës në grupe sipas aftësive (çdo grup merr detyra të ndryshme sipas vështirësisë\* të komplikuarës, por qëllimet e të mësuarit janë njëloj);
- Detyrat janë të renditura sipas komplikueshmërisë, ashtu që deri te e komplikuar arrinë vetëm më të aftit;
- Jepet detyrë e njejtë e hapur dhe çdonjëri punon me kualitet maksimal që mund ta arrijë;
- Nxënësit vetë zgjedhin detyra të cilat do t'i zgjedhin;
- Të gjithë kanë detyra të njejta, por në grup nxënësit ndihmohen me njëri tjetrin;
- Të gjithë marrin fleta punuese të njejta dhe i zgjedhin me tempon e vetë;
- Të gjithë nxënësit përpunojnë një aspekt të temës, por gjithkush në mënyrën e vetë.

**Llojet e diferencimit**

Diferencimi mund të realizohet sipas:

- **Rezultateve:** Nxënësve u jepen detyra të njejta dhe rezultate të ndryshme do të dalin në varësi nga aftësitë, vetëbesimin, përvojës etj. Ky diferencim tregon se çfarë ka bërë nxënësi.
- **Detyrë:** Nxënësit grupohen sipas nevojave të tyre dhe aftësive dhe u jepen detyra të ndryshme sipas nevojave të tyre, mundësive dhe aftësive. Disa detyra të ndryshme mund t'ju jepen atyre më pak të aftëve ose atyre me prirje. Ky diferencim tregon se për ku shkon nxënësi.
- **Mësimi individual:** Në klasa me shkallë të lartë të pavarësisë, nxënësit mundet që vetë ta ndjekin linjën e vetë për mësim, hulumtim ose aktivitet tjetër, në mënyrë individuale ose në grup.

**Gjatë diferencimit mendoni:**

- Se a është plotësuar nevoja e çdo grupi nxënësish?
- A ka evaluim të aktiviteteve të përfunduara/orët?
- A janë analizuar nevojat e çdo nxënësi?
- A ka vërtetim të shkathtësive të marra që më parë, kuptime, dije dhe qëndrime?
- Mendoni për mësimnxënien:
- Hyrja e arsimit;
- Detyra është shumë e rëndë/tepër e lehtë?

**Shtojca 2/6. PROCEDURA PËR PËRPUNIMIN DHE PËRCJELLJEN E PIA****PROCEDURA PËR PËRPUNIMIN DHE PERCJELLJEN E PIA-së**

1. Ekipi inkluziv i nxënësit përgatit PIA për nxënësin me pengesa në pajtim me potencialet dhe nevojat e tij individuale dhe i realizon masat për përkrahje në mësim në pajtim me udhëzimet nga organet profesionale për vlerësim funksional, në afat prej 30 ditësh nga dita e fillimit të mësimin të nxënësit në shkollë ose, edhe nga dita e vërtetimit të nevojës për arsim sipas PIA-së.
2. Për çdo nxënës me pengesa përgatitet PIA afatgjate, afatmesme dhe afatshkurte. Në përpunimin e **PIA-së afatgjate** marrin pjesë të gjithë anëtarët të EIN.
  - Në PIA afatgjate definohen: lëndët me të cilat planifikohen qëllimet e diferencuara/rezultatet nga mësimi; temat me numrin e orëve; strategjitë/materialet didaktike/përshtatja e arsyeshme; resurset dhe suksesi.
  - PIA afatgjate përpunohet dhe i ofrohet kordinatorit të EIN-it në formë elektronike dhe të shtypur, më së voni deri në Tetor.
3. **PIA-në afatmesme (tematike)** e përgatit arsimtari i cili punon me nxënësin me pengesa në bashkëpunim me anëtarët tjerë të EIN.
  - Çdo arsimtar i cili përgatit PIA afatmesme ia ofron kordinatorit të EIN-it.
  - Pas përfundimit të temës, arsimtari në PIA afatmesme e regjistron rezultatin e arritur të nxënësit dhe i ja ofron kordinatorit të EIN-it në formë të shtypur. Në mbështetje lëshon edhe minimum tre punime të nxënësit që i dokumentojnë arritjet.
  - Para fillimit të çdo temeje të ardhshme, arsimtari përgatit PIA afatmesme për atë temë dhe ia ofron kordinatorit të EIN-it në formë elektronike.
4. Pas përfundimit të çdo tremujori, arsimtari klasor/udhëheqësi I paraleles ia lëshon notat (përshkruese/me numra) kordinatorit të EIN-it për rezultatin e arritur të nxënësit me NVA.
5. **PIA afatshkurte** është e inkorporuar në kuadër të përgatitjes ditore.
  - Çdo arsimtarë i cili i mban mësim nxënësit me pengesa dhe cili përgatit PIA afatmesme, në përgatitjen e tij ditore, mes tjerash, planifikon dhe qëllime të diferencuara/ rezultate nga mësimi, standardet e diferencuara për notim dhe aktivitete të diferencuara/ individualizuara dhe metoda (2/13.a.).
6. Në fund të gjysmëvjetorit të parë dhe në fund të vitit mësimor, kordinatori i EIN-it bën mbikqyrje në realizimet afatgjate, afatmesme dhe afatshkurte (implementuar në përgatitjen ditore) PIA dhe përgatit raport.

**Shtojca 2/7. UDHËZIME PËR PUNIMIN E NVA DHE PROGRAMIT TË MODIFIKUAR****ETAPAT në procesin e përgatitjes së PIA-së**

1. Mbledhja e informacioneve për nxënësin (përgatija e profilit të nxënësit).
2. Vlerësimi në nivelin e të arriturave të nxënësit, duke i bashkangjitur edhe përparësitë dhe nevojat.
3. Identifikimi i nevojave prioritare për mësim të nxënësit.
4. Vedosja e detyrave vjetore dhe qëllimeve për arritjet e nxënësit.
5. Identifikimi i strategjive për përkrahje të nxënësit, përkundër rezultateve të vendosura nga mësimi.
6. Realizimi i PIA-së.
7. Kontrollim, evaluim dhe revidim të PIA-së.

**KOMPONENTET të planit individual arsimor të (PIA)**

1. Informacione për identifikim të nxënësit (profil i nxënësit).
2. Niveli rrjedhës të të arriturave në lëmitë e ndryshme.
3. Nevojat prioritare për mësim të nxënësit.
4. Detyrat vjetore dhe qëllime të arritura/rezultatet nga mësimi i nxënësit.
5. Strategjitë mësimore dhe strategjitë për notim.
6. Korrnizat kohore për realizim.
7. Raport për përparimin.
8. Anëtarët e ekipit.
9. Përcjellja, e evaluimit dhe revidimi.

**STRUKTURA e planit individual arsimor (PIA)**

Në shtojcë të informatava personale themelore në lidhje me fëmijën, PIA kyc:

- Historiku i arsimit;
- Të dhëna për intervenime e mëparshme;
- Historiku mjekësor (në rast se ka);
- Përshkrimi i nivelit të tanishëm të funksionimit të fëmijës/statusi zhvillimor në tërësi, ndërsa pastaj sipas fushave të zhvillimit-kognitiv, emocional, motivues, statusi fizik dhe social (mundësitë mentale dhe funksionalitetet e fëmijës);

- Karakteristikat individuale të fëmijës: preferencat , aftësitë, nevojat, interesat dhe ngjashëm;
- Fushat prioritare në të cilat nxënësi ka nevojë për përkrahje (fusha ku përparimi shkon më ngadalë);
- Grupimi i fushave prioritare në fushat e ndryshme funksionale gjatë sëcilës obligativisht meren parasyshë qëllimet e dhëna zhvillimore dhe intervenimet nga trupi profesional për vlerësim funksional;
- Të dhëna përkatëse për notimin si dëshmi për vendimin se nxënësi ka nevojë për përkrahje;
- Qëllime/rezultate të planifikuara nga mësimi të cilat duhet të jenë specifike, të matshme dhe të arritshme;
- Strategji mësimore dhe strategji për notim; (format, metodat, teknikat, aktivitetet, mjetet/resurset mësimore të nevojshme për realizimin e PIA;
- Lloje, nivele, përmbajtje dhe frekuenca të përkrahjes;
- Korniza kohore dhe vendi i realizimit të PIA (shkollë/klasë...);
- Raport për përparimin (në të cilin evidentohen rezultatet e arritura nga mësimi, mënyra se si do të informohet për të arriturat e nxënësit, periudha kohore në të cilën do të përgatitet raporti dhe frekuenca e informimit);
- Emra dhe pozita punuese të anëtarëve të ekipit për punimin dhe realizimin e PIA;
- Ndjekja e përparimit të nxënësit, pasqyra dhe revidimi i PIA.

## PROCEDURA PËR PËRPUNIM DHE NDJEKJE TË PROGRAMËS SË MODIFIKUAR

Në afat prej 30 ditësh nga dita e fillimit të mësimit të nxënësit në shkollë ose edhe nga dita për përcaktimin të nevojës për arritje të disa njohurive dhe shkathtësive sipas programës së modifikuar, ekipi inkluziv për nxënësin përgatit programë të modifikuar për nxënësin me pengesa/nevoja komplekse dhe në pajtim me nevojat individuale dhe potencialleve dhe i zbaton masat për përkrahje në mësim në pajtim me udhëzimet nga organet profesionale për vlerësim funksional.

Nevoja për arsimim sipas programës së modifikuar ekipi inkluziv për nxënësin e përcakton pas raportit të realizuar për përparimin e nxënësit i cili obligohet pas revidimit të PIA-së dhe konstatimit se nxënësi përsëri nuk i ka arritur qëllimet e planifikuara/rezultatet nga mësimi. EISH në pajtim me prindin e udhëzon nxënësin te oragni profesional për vlerësim funksional dhe pas marrjes së udhëzimeve nga PIA përgatit programë të modifikuar për nxënësin dhe i realizon masat për përkrahje në mësim.

1. Programa mësimore e modifikuar përgatitet për nxënësit me nevoja komplekse.
2. Programa mësimore e modifikuar përgatitet për çdo periudhë edukativo-arsimore të shkollimit fillor klasa (I-III; IV-VI; VII-IX).
3. Në përpunimin e **programës së modifikuar** marrin pjesë të gjithë anëtarët e EIN të shkollës fillore dhe shkollës fillore me qendër resursesh ku mund të realizohet edhe pjesa nga programa e modifikuar.

Në **programën e modifikuar** me periudhë zhvillimore definojnë:

1. Lëmitë (lëminë edukativo-arsimore) në të cilën nxënësit duhet të arrijnë dhe zhvillojnë pavarësi, zhvillim personal dhe marrëdhënie sociale përkatësisht shkathtësi jetësore. 2. Bëhet grupimi i të gjitha lëmive në lëmitë e ndryshme funksionale gjatë së cilës detyrueshëm merren parasysh qëllimet zhvillimore të rekomanduara dhe intervenimeve nga organi profesional për vlerësim funksional.
4. **Programën e modifikuar (tematike) afatmesme** e përgatit arsimtari i cili punon me nxënësin sipas programës së modifikuar në bashkëpunim me anëtarët tjerë të EIN-it.
  - Në programën e modifikuar (tematike) definojnë qëllimet/rezultatet nga mësimi, të bazuara në kompetencat me të cilat nxënësi duhet të arrijë: njohuri elementare dhe shkathtësi për kujdes të vetanë dhe realizimin e shprehive kulturo-higjienike, jetesë të shëndetshme, funksione psikomotorike, komunikim themelor, marrëdhënie interpersonale, marrëdhënie shoqërore dhe marrëdhënie me ambientin e jashtëm.
  - Çdo arsimtarë i cili përpunon programë të modifikuar ia ofron kordinatorit të EIN-it në formë elektronike dhe të shkruar, më së voni deri në Nëntor. – Pas kryerjes të çdo tremujori, arsimtari klasor/udhëheqësi i paraleles në mënyrë përshkruese e evidenton suksesin e arritur/përparim të nxënësit dhe ia ofron kordinatorit të EIN-it në formë të shtypur. Në mbështetje lëshon edhe minimum tri dëshmi/ punime nga nxënësi që i dokumentojnë të arriturat.
  - Para fillimit të çdo teme të ardhshme, arsimtari përpunon programë afatmesme të modifikuar për atë temë dhe ia ofron kordinatorit të EIN-it në formë elektronike.
5. Pas përfundimit të çdo tremujori, arsimtari klasor/udhëheqës i paraleles ia lëshon notat nga notimi përshkrues kordinatorit të EIN-it për suksesin e arritur të nxënësit me nevoja komplekse.
6. Programa e modifikuar afatshkurte është e inkorporuar në kuadër të përgatitjes ditore.
  - Çdo arsimtarë i cili i mban mësim nxënësit sipas programës së modifikuar edhe për të cilën përpunon programë afatmesme, në përgatitjen e vetë ditore, mes tjerash, planifikon edhe qëllime të diferencuara/rezultate nga mësimi, standarde të diferencuara për notim dhe aktivitete të diferencuara/aktivitete të individualizuara dhe metoda.

Në fund të gjysmëvjetorit të parë dhe në fund të vitit shkollor, kordinatori i EIN-it bën mbikqyrje në realizimin e programës së modifikuar afatgjate, afatmesme dhe aftshkurte (të implementuar në përgatitjen ditore) dhe përgatit raport.

## DREJTIME PËR PËRPUNIM TË PROGRAMËS SË MODIFIKUAR

### ETAPAT në proces të përgatitjes së programës së modifikuar

1. Mbledhja e informacioneve për nxënësin (përgatitje të profilit të nxënësit).
2. Vlerësim në nivel të arritjes së nxënësit.
3. Identifikimi i nevojave prioritare për mësim dhe arritjes së shkathtësive të nxënësit.
4. Parashtrimi i detyrave dhe qëllimeve zhvillimore të arritjes/rezultatet nga mësimi për nxënësin (sipas periudhave edukativo-arsimore).
5. Identifikimi i strategjive për përkrahje të nxënësit, përkundër rezultateve të parashtruara nga mësimi.
6. Realizimi i programës së modifikuar.
7. Pasqyrë, evaluim dhe revidim të programës së modifikuar.

### KOMPONENTET e programës së modifikuar

1. Informacione për identifikim të nxënësit (profil i nxënësit).
2. Niveli rrjedhës për të arriturat në lëmi të ndryshme.
3. Nevojat prioritare për mësim dhe arritje të shkathtësive.
4. Detyra dhe qëllime zhvillimore të arritjeve /të rezultateve nga mësimi i nxënësit (sipas periudhave edukativo-arsimore).
5. Strategjitë mësimore, strategjitë për përkrahje të zhvillimit të shkathtësive jetësore dhe strategjive për notim.
6. Korrnizat kohore për zbatim.
7. Raport për përparimin.
8. Anëtarët e ekipit.
9. Ndjekje, evaluim dhe revidim.

**STRUKTURA e programës, mësimore të modifikuar**

- historia e arsimit;
- të dhëna për intervenimet e mëparshme;
- historia medicinale;
- përshkrim të nivelit të tanishëm të funksionimit të fëmijut/statusi zhvillimor në tërësi, ndërsa pastaj sipas lëmvive të statusit zhvillimor-kognitiv, emocional, fizik, dhe social (mundësitë momentale dhe funksionalitete të fëmijut);
- karakteristikat individuale të fëmijut: preferencat, aftësitë, nevojat, interesat e tjerë;
- identifikimi i të gjitha lëmvive në të cilat nxënësi ka nevojë për përkrahje (lëmi në të cilën përparimi shkon shumë ngadalë);
- grupimi në të gjitha lëmitë, në lëmitë e ndryshme funksionale gjatë së cilës në mënyrë të detyrueshme merren parasyshtë qëllimet zhvillimore të udhëzuara dhe intervenime nga organi profesional për vlerësim funksional;
- të dhënat adekuate për notimin si dëshmi për vendimin se nxënësi ka nevojë nga ky lloj përkrahjeje;
- planifikohen qëllimet/rezultatet nga mësimi të cilat duhet të jenë specifike, të matura dhe të arritshme;
- identifikimi i strategjive të mësimimit, strategjive për përkrahje të zhvillimit të shkathtësive jetësore dhe strategjive për notim (forma, metoda, teknika, aktivitete, mjete mësimore/resurse, të nevojshme për realizimin e programës së modifikuar);
- llojet, nivelet, përmbajtja dhe frekuencat e përkrahjes; – korniza kohore dhe vendi i realizimit të programës së modifikuar (shkollë, klasë, në kushte shtëpiake dhe të tjera);
- raport për përparimin (në të cilin evidentohen rezultatet e arritura nga mësimi, mënyrës si do të informohet për arritjet e nxënësit, periudha kohore në të cilën do të përgatitet raporti dhe frekuenca e njoftimit);
- Emrat dhe pozicionet të anëtarëve të ekipit për përpunim dhe dhe realizim të programës së modifikuar;
- Përcjellje, evaluim dhe revidim të programës së modifikuar.

Ndonjëherë është me rëndësi më parë të krijohen kushte që të jetë i suksesshëm fëmiju në ndonjë aktivitet, me qëllim që të ngritet niveli i vetëbesimit dhe më pastaj të punohet në arritjen e e disa qëllimeve të diferencuara arsimore më të larta /rezultatet nga mësimi.

Përgjatë përcaktimit të aktiviteteve konkrete të cilat do të sjellin deri te arritja e qëllimit, nuk guxojmë të harrojmë të përgjigjemi në pyetjet: kush, kur dhe ku do t'i realizojë aktivitetet e planifikuara.



## QËLLIMET DHE DETYRAT

**Qëllimet** tregojnë për rezultatet e dëshiruara ose të arritura të cilat priten pas planifikimit të kohës për arritjet e tyre. Rezultatet e pritura janë të shprehura si deklaratat pozitive të cilat e përshkruajnë sjelljen, e cila paraprakisht vëzhgohet (ate të cilën nxënësi e arrinë, sesa ate që do ta arrijë), ose shkathtësi, ose ngjarje e cila do të ndodh gjatë kohës, së ose pas realizimit të PIA.

Qëllimet mund të jenë afatshkurta (javore, mujore) ose afatgjate (gjysmëvjetore, vjetore) në varshmëri të periudhës kohore e cila është e definuar.

Qëllimet e definuara mirë janë të qarta, konkrete, të realizueshme dhe të matshme. Me rëndësi është që qëllimet të jenë të definuara ashtu që të mundet të maten të arriturat e tyre.

Realizueshmëria e qëllimeve vlerësohet jo vetëm në lidhje me mundësinë e fëmijës, por edhe në mundësitë reale të prindërve dhe shkollës, që të kyçen në stimulimin e fëmijës. Qëllimet e vendosura lartë mund të sjellin deri në stagnim ose regresion në zhvillimin e fëmijës, të kenë ndikim negative ndaj vetëbesimit dhe motivimit.

Gjatë arritjes së qëllimeve shumë është e rëndësishme të caktohet orari ose prioriteti. Ndonjëherë është e rëndësishme së pari të krijohen kushte që fëmija të jetë i sukseshëm në ndonjë aktivitet me qëllim që të ngritet niveli i vetëbesimit, ndërsa mëpastaj të punohet që të arrihen disa qëllime arsimore më të larta.

Detyrat janë hapat e nevojshëm, të cilat duhet të ndërmerren që të arrihet qëllim konkret, dhe duhet mirë të përpunohen dhe konkretizohen.

Kur do të përcaktohen aktivitetet konkrete të cilat do të sjellin deri te arritja e qëllimit, nuk duhet të harrojmë të përgjigjemi në pyetjet: Kush, kur dhe ku t'i realizojë aktivitetet e planifikuara.

## DOKUMENTACIONI I PËRPARIMIT DHE EVALUIMI I EFEKTIVITETIT

Pjesë përbërëse e planit individual arsimor është vlerësimi i vazhdueshëm dhe mbledhja e të dhënave të cilat do të shfrytëzohen që të vërtetohet përparimi i fëmijës. Mes metodave për vlerësim janë: Shembuj nga punimet, skema të shkruara për sjellje, listat kontrolluese, shënimet anekdoteske, teste në bazë të kriterëve për arritje/standardet për vlerësim.

Është e nevojshme të caktohet vendi i realizimit të planit individual shkollor Hapësira më e natyrshme, dhe për ate vendi më i mirë për realizimin e planit individual arsimor është shkolla/ klasa. Për atë shkak, duhet të krijohen kushte për realizimin e tij në kuadër të aktiviteteve të përbashkëta në klasë, ku është e mundur, sepse ndarja e fëmijës në klasë, mund të jetë dekurajuese.

Pjesë e aktiviteteve të planifikuara mund dhe duhet të realizohen në rrethin familjar me ndihmën e prindërve, vëllezërve dhe motrave. Kur plani do t'i caktojë ushtrimet individuale (si p.sh., të folurit), dhe ata mund të realizohen në shkollë, realizimi i tyre është e mundur në qendrën e shërbimeve, qendrës shëndetësore ose në shtëpi.

## PARIMET E EKIPIT PËR PËRCJELLJE TË FËMIJËS:

Vlerësime komplete dhe gjithëpërfshirëse të fëmijës duke i patur parasysh të gjitha aspektet e zhvillimit të tij dhe jetën.

Respektimi i dëshirave të prindërve dhe fëmijëve çdoherë kur ajo është e mundur (qëllimet tona nuk duhet të imponohen, sepse ajo do të shpjen drejt rezistencës dhe tregimit të reaksioneve negative emocionale, të cilat do të na shpiejnë pas). Komunikim mes anëtarëve të ekipit është partneriteti, me respektim të mendimeve dhe propozimeve të të gjithëve në ekip, të cilat mund të jenë të ndryshme, sepse sjellja e nxënësit nuk ndodh në të njëjtin kontekst social ose kohë. Kjo është në veçanti e rëndësishme kur fëmija vjen nga një rreth i rrezikuar kulturor e social.

Ekipi është i fokusuar në potencialin e fëmijës dhe ata i përcaktojnë aktivitetet dhe detyrat individuale të çdo anëtari të ekipit. Kënaqësia e fëmijës është bazë e fuqishme për krijimin dhe mbajtjen e motivimit.

Ajo është me rëndësi qenësore se puna ka suksese të vogla, por të realizueshme dhe të arritura, dhe për ate janë të gjithë të ndërgjegjshëm (prindi dhe fëmija dhe anëtarët e ekipit, arsimtarët).

Qëllimi kryesor/ prioriteti është çdoherë në interesin më të mirë të fëmijës (arsim, punë, motivim, ndjenja e suksesit, pranimi i pjesëmarrësve) dhe duhet të jetë kriter i vetëm i validitetit të masave dhe qëllimeve (anëtarët e ekipit mund të kenë ide të ndryshme për ate se çfarë është më e mirë për fëmijën, stimulime të cilat japin rezultate),

## VLERËSIMI

Me implementimin e planit individual arsimor parashtrohet si pyetje – si të realizohet vlerësimi i fëmijës me pengesa, i cili mëson në shkollat e rregullta sipas PIA? A duhet të realizohet në bazë të standardeve shtetërore për vlerësim ose në varësi me qëllimet në PIA.

Nëse fëmija mirë përparon dhe arrinë rezultate të caktuara nga planet individuale arsimore, por ato të arritura ende janë nën ose në nivelin e rezultatit minimal nga aktivitetet e planifikuara, do ta vlerësojmë për të arriturën, ndërsa tjetrën do të vazhdojmë ta realizojmë. Do të bëjmë vlerësim tonin dhe do ta shpërndajmë me anëtarët e ekipit inkluziv dhe do të sjellim vendim të përbashkët.

Nota duhet të jetë motivuese për fëmijën, dhe çdoherë kur është e mundur duhet të shfrytëzohet notimi me shkrim.

## NOTIMI

Me implementimin e planit arsimor-individual parashtrohen pyetjet vijuese:

Si të bëhet notimi i fëmijës me pengesa, i cili meson në shkollë të rregullt sipas PIA ose sipas programs së modifikuar? Atë bëhet notimi sipas standardeve shtetërore për notim ose në raport për qëllimet/ rrezultatet e mësimin në PIA.

Notimi i nxënësve me pengesa është pjesë përbërëse e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe paraqet proces të përcjelljes në kontinuitet, kontrollim dhe vlerësim të të arriturave të nxënësve në mësim.

Mënyra e ndjekjes dhe notimit të secilit nxënës veç e veç përshtatet në bazë të aftësive të tij kognitive, mundësive, kufizimit të mënyrës së shprehurit.

Për nxënësit të cilët ndjekin mësimin sipas planit individual arsimor, notimi është sipas angazhimit të nxënësit dhe shkallës së arriturave të qëllimeve /rrezultateve të përshtatura nga të mësuarit dhe standardeve për notim, ndërsa për nxënësit të cilët ndjekin mësimin me program të modifikuar sipas angazhimit dhe shkallës së të arriturave të qëllimeve/rrezultateve të përshtatura kuptueshëm nga mësimi dhe standardet për notim.

Nëse fëmija përparon mirë dhe nëse arrin qëllime/rrezultate të caktuara nga planet individuale arsimore, por ata të arritura ende janë nën nivelin e minimumit nga të arriturat e aktiviteteve të planifikuara, do ta notojmë për të arriturat, kurse pjesën tjetër do ta vazhdojmë ta analizojmë. Do të bëjmë vlerësimin tonë dhe do ta shpërndajmë me anëtarët e ekipit inkluziv dhe do të sjellim vendim të përbashkët.

Për notimin e të arriturave të nxënësit shfrytëzohet notimi diagnostik, formativ dhe sumativ gjatë së cilës mënyra e notimit përshtatet me nevojat specifike të nxënësve me zbatim të: testeve me shkrim në alfabetin e Braillit, format i zmadhuar, në versionin elektronik, në formatin audio dhe ngjashëm, përdorimi i teknologjisë asistive, kohë më të gjatë për testim, ndihmë për leximin e pyetjeve të testit, pauza të mbikqyrura dhe plan arsimor fleksibil, presencë e asistentit arsimor.

Nota duhet të jetë motivuese për fëmijën dhe gjithmonë kur është e mundëshme të shfrytëzohet notimi me shkrim.

Për mënyrën e notimit të nxënësve me pengesa është përgatitur rregullore e veçantë.

**Shtojca 2/8. PROCEDURA PËR PËRPUNIMIN E PIA****PROCEDURA PËR PËRPUNIMIN E PIA**

(shembuj nga shkolla)

**Hapat për përpunimin e PIA**

1. Analiza e situatës dhe mbledhja e të dhënave dhe informacioneve për fëmijën
2. Përpunimi i profilit pedagogjik të fëmijës
3. Caktimi i prioriteteve për ofrimin e përkrahjes
4. Caktimi i qëllimeve të fundit, plan detal të aktiviteteve dhe zhvillimi i strategjive për përkrahje

**Përmbajtja e dokumenteve të PIA-së**

PIA është dokument i shkruar i shkollës, në të cilin planifikohet përkrahje plotësuese në arsimin dhe edukimin e nxënësit.

*PIA formulari përmban:*

- Të dhëna personale të nxënësit/nxënëses.
- Profili pedagogjik i nxënësit/nxënëses – përshkrim i shkurtër i zhvillimit dhe arsimimit, gjendja e nxënësit/nxënëses.
- Vlerësimi i nevojave për përkrahje – qëllimi i procesit edukativo-arsimor, përkatësisht nevoja nga përkrahja plotësuese.
- Plani i aktiviteteve sipas lëndëve mësimore/lëmive –përshkrim operacionalizues të përkrahjes me aktivitete individuale, përkatësisht hapat dhe renditja e tyre në grupe edhe nëpër orë, nëpër klasa, si dhe përshkrimi i orarit jashtë nga paralelja, kur ajo është e nevojshme.

**Kush e përpunon PIA-në?**

Ekipin për përpunimin e PIA-së për nxënësit e përbëjnë:

- arsimtarët klasorë/lëndorë
- punëtori profesional në shkollë
- prindi i nxënësit
- personi profesional i jashtëm (sipas nevojës)

### Procedurat për përpunimin e PIA

- Kujdestari i klasës me EISH i mbledh të dhënat e nevojshme dhe informacione, e analizon situatën dhe përpunon profil pedagogjik të nxënësit/nxënësës.
- Vlerësohen nevojat për përkrahje dhe lëmitë prioritare për të cilat është e nevojshme që të përpunohet PIA. Punohet në mënyrë ekipore, në takimet e punës së anëtarëve të EISH.
- EISH sjell vendim për përpunimin të PIA dhe formon ekip për përkrahje plotësuese, i cili e përpunon PIA për nxënësin.
- EISH pas sjelljes së vendimit për pranimin e propozimit të Drejtorit të shkollës, propozon anëtarë për ekipi për dhënie të nihmës dhe përkrahje plotësuese të nxënësit.
- Drejtori i shkollës, pas marrjes së pëlqimit me shkrim nga prindi, përkatësisht kujdestari, formon ekip për dhënie të përkrahje plotësuese të nxënësit.
- Ekipin për përkrahje plotësuese në shkollë e përbëjnë:
  - Arsimtari i klasës të paraleles, përkatësisht arsimtari klasor / kujdestar, arsimtari lëndor,
  - Bashkëpunëtori profesional,
  - prindi, përkatësisht kujdestari i fëmijës, në pëlqim me nevojën e nxënësit,
  - asistenti pedagogjik (vullnetar), përkatësisht profesioist jashtë shkollës me propozim të prindit/kujdestarit
- Prindi nënshkruan pëlqim për punimin e PIA
- Anëtarë të ekipit për përkrahje plotësuese dhe prindi përpunojnë strategji për përkrahje dhe plan detal të aktiviteteve për disa lëndë mësimore/lëmi.
- Ekipi për përkrahje plotësuese të nxënësit, përgatit PIA.
- Prindi, përkatësisht kujdestari, jep pëlqim për realizimin e PIA.
- PIA e përpunuar, ekipi profesional për arsim inkluziv të shkollës e lëshon deri te Këshilli i arsimtarëve për miratim.

### Vlerësim i nxënësit sipas PIA

- Vlerësimi bëhet sipas qëllimeve të përcaktuara dhe rezultateve të pritura nga PIA.
- Në procesin e vërtetimit dhe vlerësimit është e nevojshme që të përshtaten kërkesat/detyrat/pyetjet për nxënësin me PIA.
- Rezultatet e pritura mund të jenë tërësisht të arritura (nota 4 dhe 5) dhe pjesërisht të arritura (notat 2 dhe 3).
- Gjatë notimit të nxënësve me PIA është e nevojshme t'i iket notës pamjaftueshëm (1). Preferohen:
  - Ndryshimi i strategjive të përshtatjes me revidim eventual të rezultateve të pritura
  - Mësimi plotësues

### Evaluimi i fëmijës sipas PIA

- Evaluimin (vlerësimi) e PIA-së e përbëjnë teknikat si vijojnë:
- Vlerësimi i shkallës së arritur (rezultatet e pritura) të cilat janë të definuara në kuadër të aktiviteteve të planit në PIA
- Anëtarë të EISH bashkërisht vlerësojnë se sa nxënësi/nxënësja i ka përvetësuar rezultatet e pritura
- Vlerësim të shkallës së efikasitetit të disa lloje përshtatjesh të parapara me PIA dhe të zbatuara gjatë mësimit.
- Anëtarë të EISH bashkërisht e vlerësojnë shkallën e efikasitetit të disa strategjive të zbatuara. Vlerësohet suksesshmëria në:
  - Përshtatje të përmbajtjeve, metodave, formave dhe të mjeteve konkretizuese dhe vlerësimi
  - Përshtatje e hapsirës/kushtet në të cilat mbahet mësimi (largimi i barrierave fizike, organizimi specifik dhe orari i aktiviteteve)
  - Përshtatje e përmbajtjeve të mësimit dhe standardet e të arriturave

**Shtojca 2/9. FLETA PËR OBSERVIM TË NXËNËSIT NË KLASË****FLETA PËR OBSERVIM TË NXËNËSIT NË KLASË**

Emri dhe mbiemri i nxënësit	
Data e observimit	
Arsimtari/Lënda	
A është paraparë që për nxënësin të planifikohen qëllime të diferencuara	
A janë planifikuar për nxënësin aktivitete të veçanta	
Si është planifikuar koha për realizimin e aktiviteteve	
Raporti i nxënësit me arsimtarin dhe arsimtarit me nxënësin	
Raporti i nxënësit ndaj: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Detyrave që i merr,</li> <li>• Nxënësve tjerë</li> <li>• Materialit didaktik</li> </ul>	
Pozita e trupit, mënyra e të ndejturit, shkathtësia...	
Raporti i nxënësve të tjerë ndaj nxënësit	

Bashkëpunëtori profesional

\_\_\_\_\_

**Shtojca 2/10. FLETA PËR VLERËSIMIN E NXËNËSIT**

**FLETA PËR VLERËSIMIN E NXËNËSIT** \_\_\_\_\_ **data:** \_\_\_\_\_

<p><b>Perspektiva e familjes ose e fëmijës</b></p>			
<p><b>Perspektiva profesionale</b></p>	<p>Funksionet trupore dhe struktura</p>	<p>Aktiviteti</p>	<p>Pjesëmarrja</p>
<p><b>Përkrahja dhe lidhja</b></p>	<p>Faktorët e mjedisit</p>	<p>Faktorët personal</p>	<p>Informata tjera</p>

## Shtojca 2/11. PROFILI PEDAGOGJIK I NXËNËSIT/NXËNËSES

## PROFILI PEDAGOGJIK I NXËNËSIT/NXËNËSES

Përparësitë (anët e forta) dhe intereset e nxënësit/nxënësës	Nevoja për përkrahje
Të mësuarit dhe si mëson (të ndahen faktete e rëndësishme për të ariturat e deri tanishme arsimore, llojet e të mësuarit, qëndrimi ndaj shkollës, motivimi për mësim, intereset, lëmitë dhe si këta aspekte të sjelljes manifestohen në situata të ndryshme)	
Shkathësitë sociale (të ndahen faktet e rëndësishme për raportin me të tjerët, të ritur dhe moshatarë, respektimi i rregullave dhe reagimi në situata konkrete)	
Shkathësitë e komunikimit (të ndahen faktet e rëndësishme për mënyrat e shkëmbimit të informatave me të tjerët, duke kështu edhe shkallën e njohjes së gjuhës në të cilën arsimohet si dhe pengesat në shfrytëzimin e mjeteve simbolike dhe vizuale të komunikimit)	
Pavarësia dhe kujdesi për veten (të ndahen faktet e rëndësishme për aftësitë për përkujdesjen për vete dhe ti plotëson obligimet e përditëshme në shtëpi dhe në shkollë)	
Ndikimi i jashtëm i të mësuarit (të ndahen faktet e rëndësishme për kushtet familjare dhe të tjera të cilat mund të ndikojnë në të mësuarit dhe përparimin e nxënësit)	
Fushat dhe nevojat prioritare të identifikuara për përkrahje në arsim	Përkrahja shtuese për të cilën është e nevojshme leje:

**Shtojca 2/12. PLANI INDIVIDUAL ARSIMOR AFATGJATË DHE AFATSHKURTËR**

**PLANI INDIVIDUAL ARSIMOR AFATGJATË**

Emri dhe mbiemri \_\_\_\_\_, Datëlindja \_\_\_\_\_, Klasa \_\_\_\_\_  
 Arsimtari \_\_\_\_\_, Data \_\_\_\_\_, Ndihma nga prindët \_\_\_\_\_

Lëndët mësimore	Temat me numrin e orëve	Qëllimet mësimore /rezultatet nga mësimi	Strategji/materiale didaktike/përshtatje e kuptueshme	Resurse	Suksesi

**PLANI INDIVIDUAL ARSIMOR AFATSHKURTË**

Emri dhe mbiemri \_\_\_\_\_, Datëlindja \_\_\_\_\_, Klasa \_\_\_\_\_  
 Arsimtari \_\_\_\_\_, Data \_\_\_\_\_  
 Lënda mësimore \_\_\_\_\_, Tema \_\_\_\_\_

Përmbajta mësimore me numrin e orëve	Qëllimet/rezultatet mësimore	Suksesi



**Shtojca 2/13-a. FORMATI I PLANIT INDIVIDUAL ARSIMOR**

**PLANIFIKIMI I PUNËS MË NXËNËS SIPAS TEMAVE DHE PËRMBAJTJEVE**

FUSHA/LËNDA	Nxënësi						
	A duhet të përshtatet qasja				Ndryshime		
	Nuk duhet	Hapësira dhe kushtet	Prëmbajtjet	Metodat	Masat plotësuese për përkrahje	Ndryshime në programin	Vlerësimi në çfarë mënyrë)

Vazhdon në faqen tjetër

VLERËSIMI I NEVOJAVE PËR PËRKRAHJE				
Masat/lloji i përkrahjes	Masa të nevojshme/lloje të përkrahjes (aktivitete, iëndët, fushat)	Përshkrim i shkurtër i masave/llojet e përkrahjes dhe qëllimet	Realizimi dhe evaluimi	
Përshtatja e metodave, materialeve dhe mjeteve mësimore (masa për individualizim)				
Përshtatja e hapësirës/kushtet në të cilat realizohen aktivitetet/mësimi (si p.sh. menjarimi i barrierave fizike, organizimi specifik dhe orari i aktiviteteve, etj.)				
Ndryshimi i përbajtjes së aktiviteteve dhe të priturave, në realitet i përbajtjes mësimore dhe standardeve arsimore				
Masa të tjera të përkrahjes				

## Shtojcë 2/13-b. FORMATI I PLANIT INDIVIDUAL ARSIMOR

## PLANI INDIVIDUAL ARSIMOR

TË DHËNAT PERSONALE PËR NXËNËSIN (PROFILI I NXËNËSIT)	
Emri dhe mbiemri	
Datëlindja	
Vendi dhe adresa ku jeton	
Emri dhe mbiemri i prindit/kujdestarit	
Vendi dhe adresa ku jeton prindi/kujdestari (në rast se nuk është e njëjta)	
Rezultati mjekësor/dokumentacioni	
Klasa	
PËRSHRIMI I TANISHËM I FUNKSIONIMIT TË FËMIJËS	
Statusi zhvillimor në tërësi (mundësitë dhe funksionalitetet momentale të fëmijës)	
Zhvillimi – statusi kognitiv	
Statusi motivues	
Statusi fizik	
Statusi emocional	

TË DHËNAT PERSONALE PËR NXËNËSIN (PROFILI I NXËNËSIT)	
Statusi social	
NIVELI RRJEDHËS I TË ARRITURAVE NË FUSHA TË NDRYSHME	
Informata të rëndësishme për arsimimin e mëparshëm, masat e individualizimit, rehabilitimit dhe ngjashëm	
Fushat prioritare në të cilat nxënësi ka nevojë për përkrahje (fush ka përparimi shkon më ngadalë)	
Ndjekja e përparimit të nxënësit, pasqyra dhe revidimi i PIA	
Raport për përparimin (në të cilin janë të evidentuar rezultatet e arritura nga mësimi, mënyra se si do të informohet për të arriturat e nxënësit, periudha kohore kur do të përgatitet raporti dhe frekuenca e raportit)	
Kush bën shikimin e PIA në bazë të pëlqimit të prindit/kujdestarit	
Emrat dhe pozitat e punës së anëtarëve të ekipit për përgatitjen dhe realizimin e PIA	
Kordinator/ë të ekipit për përkrahje shtesë të nxënësit	
Pëlqim nga prindi/kujdestari për realizimin e PIA – nënshkrimi dhe data	
Pëlqim nga prindi/kujdestari për ndërprerje të realizimit të PIA - nënshkrimi dhe data	

## Shtojca 2/13-c. FORMATI PËR PLANIN INDIVIDUAL ARSIMOR

## ROGRAMI INDIVIDUAL ARSIMOR

Viti shkollor \_\_\_\_\_

Informatat identifikuese	
Emri, emri i babës dhe mbiemri i nxënësit:	
Datëlindja:	
Vendlindja:	
Klasa:	
Kujdestari i klasës:	

## GJENDJA INICUESE

Anët e forta dhe interesimet e nxënësit	Nevojat për përkrahje
<b>1. Të mësuarit dhe si mëson</b>	
<b>2. Shkathtësitë sociale</b>	
<b>3. Shkathtësitë komunikative</b>	
<b>4. Pavarësia dhe kujdesi për veten</b>	
<b>5. Ndikimi dhe rrethanat e jashtëme ndaj mësimit</b>	

<b>Lëndët sipas të cilave do të punohet më qëllimet e diferencuara</b>
<b>Lëndët në të cilat nxënësi nuk do të punojë sipas PIA</b>

<b>STRATEGJITË E PËRSHTATJES</b>
<b>Përshtatja e hapësirës dhe kushtet për punë:</b>
<b>Përshtatja në raport me materialet dhe materialet ndihmëse metodiko/didaktike:</b>
<b>Përshtatja në raport me metodat, format dhe teknikat e punës:</b>
<b>Ndjekja dhe notimi</b>

**Përshtatja në raport me përmbajtjet, qëllimet dhe të priturat dhe të ariturat**

--

**Lënda mësimore:****Arsimtari:****Tema mësimore/temat:****Koha e realizimit:**

QËLLIMET E DIFERENCUARA	STRATEGJITË E DIFERENCUARA	REZULTATET

**EVALUIMI****PERIUDHA E EVALUIMIT:****QËLLIMET E ARRITURA:**

--

**QËLLIMET E PA ARRITURA:**

--

**REKOMANDIME PËR PERIUDHËN E ARDHËSHME:**

--

Anëtarët e Ekipit inkluziv për nxënësin të cilët e punuan programin individual edukativo-arsimor:

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_
4. \_\_\_\_\_
5. \_\_\_\_\_

**Shtojca 2/13-d. FORMATI I PLANIT INDIVIDUAL ARSIMOR**

<b>PLANI INDIVIDUAL ARSIMOR</b> (emri i nxënësit)		<b>Profili i nxënësit:</b>		<b>Sqarimi i fushave:</b>  Këtu janë vendosur informatat të cilat tregojnë se për cilin nxënëës punohet
		<b>Hobi/intereset:</b> (shëno këtu)		
	Punon mjete mësimore dhe mjete për punë inkluzive.				
	Disiplina në klasë është bazuar në klimën pozitive të klasës dhe oranzimin e mirë si dhe udhëheqjen e orës.				

Konstatimet tjera relevante
Takim pas ndjekjes
Arsimtari bën refleksion (arritja e qëllimeve, vështirësi dhe kahje për përmirësim). P Pj J /
Anët e forta: Propozime dhe sygjerime për përparimin e punës:
Fusha për zhvillimin e mëtutjeshëm:
Ndryshimet te arsimtari nga ndjekja e mëparëshme:

**Shtojca 3/4. ÇEK LISTA PËR VETËVLERËSIM TË INKLUZIVITETIT****STRATEGJITË INKLUZIVE MËSIMORE**

(Vetënotimi në praktikën vetjake të arsimtarit)

**A shfrytëzoni ose a do të kishit shfrytëzuar një nga këta strategji në vijim?**

Legjenda:

- ✓ - Këtë e shfrytëzojë në mësimin tim
- ~ - Në njëfarë mënyre, e shfrytëzojë këtë në mësimin tim
- x - Nuk e shfrytëzojë këtë në mësimin tim
- \* - Do të kisha dashur/ të përpiqem me këte, edhe pse më duhen informacione plotësuese dhe resurse

**Interakcioni arsimtar – nxënës:**

- I di dhe i përdorë emrat e nxënësve ashtu si ata zgjedhin që t'i emëroj dhe me artikulum të drejtë.
- Nxënësve ua bëj me dije se si të më drejtohen, në veçanti nëse vijnë nga ambiente të ndryshme kulturore dhe arsimore.
- Në fillim të vitit shkollor (ose kur i takojë për herë të parë) realizoj pyetësorë që të njihem me paranojuri të e nxënësve, përvojat e tyre të mëparshme arsimore, ambiciet profesionale, interesat, etj.
- I nxis nxënësit që t'i vizitojnë orët plotësuese dhe orët për konsultim, dhe ta shfrytëzojnë këtë kohë për të pyetur për përmbajtjet mësimore, si dhe për interesat e tyre jasht orëve.
- Nxënësve ua bëj me dije se kam të pritura të mëdha nga ata dhe besoj se të gjithë nxënësit mund të mësojnë.
- Nxënësve ua bëj të ditur se është e dobishme që të përpiqen dhe nuk është e tmershme nëse nuk do të kenë sukses ( të provojnë edhe pse ndoshta nuk do të kenë sukses). Të dinë se mospjesëmarrja dhe sfida janë pjesë të rëndësishme në procesin e nësimimit.
- Përpiqem që nxënësit të japin më shumë përgjigje ose pikëpamje në pyetjet e parashtruara.
- I shmangem talljes në kurriz të nxënësve.
- Kam kujdes se cilët nxënës i pyes të flasin për grupe të caktuara sociale.
- Tregoj kujdes për mirëqenien e nxënësve, dhe i ndaj informacionet nga resurset (si p.sh.për këshillim dhe shërbime psikologjike, shërbime për nxënësit me nevoja të veçanta dhe të ngjashme).
- E shfrytëzojë çdo mundësi, në bisedë ose në formën e shkruar, të tregojë se mësimin përpiqem ta bëjë të kapshme njëlloj për të gjithë nxënësit.
- Me kujdes i paramendoj aktivitetet të cilat hapin tema potenciale të ndjeshme ose të papëlqyeshme.
- Papajtueshmërinë e shëndroj në produktivitet duke i drejtuar nxënësit që të kritikojnë deklaratë ose ide, ndërsa jo folësin.

- E ndërprej ose intervenoj në diskutim nëse komentet bëhen fyese ose i devalvojnë nxënësit tjerë.
- U jap informacione kthyesë nxënësve për përvojat e tyre gjatë mësimit.
- I ftoj kolegët dhe bashkëpunëtorët profesional që të vizitojnë dhe të ndjekin orë të miat që të më japin informacione kthyesë rreth bashkangjites ose komunikimin me nxënës të ndryshëm.

#### **Interaksioni nxënës –nxënës:**

- I nxis nxënësit që t'i mësojnë dhe mes vetes t'i shfrytëzojnë emrat e tyre.
- Përdori ushtrime për relaksim, gjatë së cilave nxënësit do të mund të mësojnë njëri për tjetrin.
- Përgatis udhëzime, rregulla themelore ose marrëveshje të përbashkëta për marrje pjesë aktive në orë.
- Zbatoj forma të punës në grupe më të vogla.
- Nga nxënësit kërkojë që të shkruajnë dhe të ndajnë informacione për prejardhjen e tyre të cilat mund të ndihmojnë për ndonjë aktivitet të caktuar në orë. Dallueshmërinë e nxënësve e paraqes si mjet. mjet ndihmës për të mësuar më shumë.
- Gjatë punës ekipe afatgjate, nga nxënësit kërkojë që të japin informacione kthyesë në lidhje me punën në grup.
- I gjej të gjitha mundësitë nga programa mësimore, të cilat ndihmojnë që të nxënësit të ndërtohen shkathtësitë për bashkëpunim.
- Gjatë orëve e theksoj rëndësinë e bashkëpunimit në mësim. Nxënësve u mundësojë që të mendojnë për ate që kanë mësuar përmes aktiviteteve të përbashkëta (formale dhe joformale).
- Me qëllim formoj grupe të vogla heterogjene në të cilat janë të kyçur edhe nxënësit e marginalizuar.
- Me qëllim formoj grupe nga nxënës me përparësi dhe aftësi të ndryshme .
- Mundësojë që nxënësit vetë të vetëvlerësohen dhe të zbatojnë vlerësim mes-nxënësve (moshatarë).
- Nxënësit i kyç në grupe aktivitete të vogla të cilat do t'u ndihmojnë që t'i shqirëtojnë dhe vlerësojnë kontributin e tjerëve.
- Vendosi rregulla për reagim nga ana e nxënësve nëse ata ndjejnë se një perspektivë e caktuar është e nënçmuar ose nuk është e pranuar.

#### **Përmbajtja:**

- Zgjedh përmbajtje dhe aktivitete të cilat e shprehin dallueshmërinë e nxënësve në një lëmi të caktuar.
- Shfrytëzojë mjete vizuale të cilat nuk i përforcojnë stereotipet, por bashkangjesin njerëz të ndryshëm dhe perspektiva.
- Shfrytëzojë shembuj nga më të ndryshmit që t'i ilustrojë konceptet, duke shfrytëzuar informacione nga më shumë lëmi të ndryshme.
- Flas për më shumë persona të ndryshëm dhe ekspertë të cilët kanë kontribuar për lëminë për të cilën mësohet dhe e theksojë prejardhjen e ndryshme të tyre.
- Në pyetjet nga testet, detyrat, si dhe temat për hulumtim, shfrytëzoj emra të ndryshëm dhe kontekste socio-kulturale.



- Zgjedh materiale, mjete dhe mënyra për mësim të cilat nxënësit do të mund nga ana financiare që t'i përballojnë.
- E analizojë përmbajtjen e shembujve të mi, analogji dhe humor, nga aspekti që të kontribuojnë të largohen nxënësit me qëndrime të ndryshme, dije ose aftësi.
- Emrat e autorëve i theksoj të plotë, dhe jo vetëm inicialet, kur flasim për ta. (Kjo mund të ndihmojë që të theksohet dallueshmëria e gjinive, grupeve dhe llojeve tjera ose të zhduken supozimet joad-ekuete për autorësinë).

### **Praktikat mësimore**

- I vlerësoj paranjohuritë e nxënësve për temë të caktuar, që të mund saktë ta përshtas mësimin me nevojat e tyre.
- U ndihmojë nxënësve që t'i ndëlidhin njohuritë e mëparshme me mësimin e ri (pëshembull, para marrjes së temës së re, kërkojë nga nxënësit në mënyrë të pavarur të mendojnë për ate që veç më e dinë për temën).
- Nga nxënësit kërkoj të japin ose të njohin shembuj të cilët e ilustrojnë të kuptuarit e përmbajtjeve.
- Shfrytëzojë metoda mësimore të ndryshme dhe mënyra të realizimit të mësimin (verbale, vizuale, interaktive, frontale, dhe të tjera), në vend që të bazohem vetën në një mënyrë të të mësuarit të nxënësve.
- E përshtas tempon e orës me çka nxënësve u mundësojë të marrin shënime gjatë kohës së mbajtjes së mësimin me çka nxënësve u mundësojë ta marrin shënime gjatë mësimin.
- I theksojë dhe sqarojë të priturat e mia dhe mënyrën e vlerësimit për çdo detyrë dhe obligim të cilin ua jap.
- Planifikojë pjesë të orës në të cilin nxënësit do të pyesin dhe diskutojnë në lidhje me detyrat ose të priturat nga detyrat dhe obligimet.
- Çdoherë e theksojë qëllimin kryesor ose vlerë të përmbajtjeve të cilat mësohen.
- Diskutimet i ndërtojë ashtu që të mund të bashkangjiten numër më i madh i nxënësve: Për shembull, kërkoj t'i dëgjoj ata të cilët nuk kanë folur, pres që të rritet numri të duarëve të ngritura, shfrytëzojë aktivitete për të menduar dhe ndarjes në çifte.
- Në orë shfrytëzojë aktivitete të shkurtëra për të shkruar, për të marrë informacione kthyesë për ate që nxënësit e kanë mësuar dhe si e kanë paramenduar.

### Shtojca 3/5. KOMPETENCAT PROFESIONALE TË ARSIMTARËVE PËR INKLUZION SOCIAL DHE ARSIMOR

#### KOMPETENCAT PROFESIONALE TË ARSIMTARËVE PËR INKLUZION SOCIAL DHE ARSIMOR

(për vetëvlerësim ose vlerësim nga anëtar të EISH)

##### 1. Kompetencat themelore profesionale për inkluzion social dhe arsimor

###### ***Njohuri profesionale dhe të kuptuarit***

- Njeh kocepte të ndryshme dhe modele për inkluzion arsimor.
- I njeh faktorët social dhe kulturor dhe se si ata ndikojnë në arsim dhe si arsimi ndihmon në kohezionin social.
- I njeh llojet e ndryshme të nxënësve të cilëve u është e nevojshme përkrahja plotësuese në arsim: Nevoja të veçanta arsimore, vështirësi në mësim dhe dhe mungesa nga shkaqet socio-ekonomike.
- I njeh konventat për të drejtat e fëmijëve dhe të antidiskriminimit.

###### ***Aftësi dhe shkathtësi profesionale***

- Pjesëmarrje në procesin e identifikimit të nevojave specifike arsimore, bashkërisht me shërbimin profesional dhe shfrytëzon metoda të ndryshme për diferencim dhe individualizim të mësimin.
- Merr pjesë në ekipin për përpunimin e planeve individuale arsimore.
- Shfrytëzon strategji të cilat promovojnë respekt të dallimeve dhe vlerave demokratike.
- Punon në ekipet inkluzive shkollore.
- Jep mundësi të barabarta që çdo fëmijë dhe familje të marrin pjesë në aktivitetet mësimore dhe jashtëmësimore, pavarësisht aftësive psikofizike, gjinisë, përkatësisë etnike, kulturës, gjuhës amëtare, religjionit, strukturës familjare, dhe statusit social dhe ekonomik.
- I përgatit nxënësit që t'i pranojnë fëmijët nga grupet e rrezikuara dhe fëmijët me nevoja të veçanta arsimore.

##### 2. Kompetencat e arsimtarit – Mentor

###### ***Zhvillon qasje për ndërtim të shkollës inkluzive.***

- Punon në projekte dhe hulumtime me dhe për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, integrim, integrim ndëretnik dhe/ose inkluzion socio – ekonomik në kuadër të shkollës.
- U ndihmon kolegëve në punimin e programeve individuale arsimore, materialeve dhe qasjeve.
- Është anëtar i ekipit inkluziv shkollor në shkollë.
- Ngrit iniciativa dhe ndërmerr aktivitete që dallimet të jenë të njohura dhe të respektuara në nivel të shkollës dhe në bashkësinë më të gjerë.

##### 3. Kompetencat e arsimtarit –Këshilltar

###### ***Kontribon për inkluzionin e fëmijëve në bashkësinë më të gjerë.***

- Ndërmerr aktivitete në nivel të shkollës dhe bashkësinë më të gjerë për tejkalim më efektiv dhe eliminim të materialeve, situatave dhe aktiviteteve të cilat nuk promovojnë barabarësi.
- Propozon dhe ndërmerr aktivitete për kyçje të nxënësve në jetën dhe punën e bashkësisë lokale pavarësisht aftësive të tyre, prejardhjen dhe gjendjen socio-ekonomike.
- Merr pjesë në përpunimin e dokumenteve për përmirësim të arsimit inkluziv në nivel qendror dhe lokal

### Shtojca 3/6. KOMPETENCAT PROFESIONALE TË ARSIMTARËVE PËR INKLuzionIN SOCIAL DHE ARSIMOR

#### VETËVLERËSIMI I KOMPETENCAVE PROFESIONALE TË ARSIMTARËVE PËR INKLuzion SOCIAL DHE ARSIMOR

Shkolla		Viti shkollor	
Arsimtari			
Klasa		Data	

Aspak nuk është e zhvilluar (trajnim i domosdoshëm)	<b>1</b>
Pjesërisht e zhvilluar (ka nevojë për trajnim)	<b>2</b>
Mirë e zhvilluar (nuk ka nevojë për trajnim)	<b>3</b>
Shumë mirë e zhvilluar (mund t'ju jep përkrahje të tjerëve)	<b>4</b>

	Kryeni vetëvlerësim në nivel (shkallë) sa janë zhvilluar shkathtësitë dhe aftësitë vijuese te ju (shënoni shënjen Pnë kolonën përkatëse).	niveli			
		1	2	3	4
<b>NJOHJA E NXËNËSVE DHE DALJA NË NDIHMË NEVOJAVE TË TYRE</b>					
1	Ndjekja e zhvillimit kognitiv, socio-emocional dhe psikomotorik të nxënësve.				
2	Sigurimi, azhorimi dhe ruajtja e sigurtë e të dhënave për çdo nxënës.				
3	Individualizimi dhe diferencimi në mësimdhënie i bazuar në njohjen e nevojave të nxënësve.				
4	Organizimi dhe realizimi i mësimin plotësues.				
5	Organizimi dhe realizimi i mësimin shtues.				
6	Nxitja, përgatitja dhe organizimi i nxënësve për pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme (gara, konkurse, ekspozita, çfaqje, projekte...).				
7	Shfrytëzimi i aktiviteteve edukative të cilat e nxisin zhvillimin kognitiv, afektiv dhe psikomotorik të nxënësve.				
8	Mundësimi i participimit demokratik të nxënësve në jetën në shkollë.				
<b>INKLUZIONI SOCIAL DHE ARSIMOR</b>					
1	Bërja e planeve individuale arsimore.				
2	Planifikimi i mësimin për tërë klasën/paralelen me respektim të dallimeve individuale ndërmjet nxënësve.				
3	Zbatimi i strategjive inkluzive për mësimdhënie dhe mësimnxënie.				
4	Ndjekja dhe vlerësimi i të arriturave dhe zhvillimin e nxënësit në pajtueshmëri me qëllimet individuale.				
5	Realizimi i aktiviteteve inkluzive në shkollë.				
6	Punimi i planit për punë dhe bashkëpunimi me familjet e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore.				
7	Punimi i mjeteve mësimore për punë inkluzive sëbashku me nxënësit.				
8	Adaptimi i klasës sipas nevojave të nxënësve me pengesa trupore.				
9	Kyçja e familjeve dhe nxënësve në aktivitete të përbashkëta për respektimin e dallimeve dhe integrimi interkulturor.				
10	Orientimi profesional i nxënësve me nevoja të veçanta arsimore.				
11	Puna individuale me nxënësit të cilët kanë nevojë për ndihmë.				

**Shtojca 3/7. SHEMBULL DREJTIMESH NGA EKUPI INKLUZIV SHKOLLOR****DREJTIMET E ARSIMTARËVE PËR PËRMIRËSIMIN E PRAKTIKËS INKLUZIVE**

**Motoja:** Përmes bashkëpunimit dhe mundit të orientuar, të gjithë nxënësit mundet aktivisht të marrin pjesë

1. **PROMOVONI SOCIALIZIM** –Ulni nxënësit me NVA afër nxënësve tjerë. Kur afër nxënësit ulet një më i rritur, ekziston mundësia që nxënësit tjerë që të ndjehen të painkurajuar për komunikim me nxënësin. Këshilloni edhe asistentët e nxënësit ose edukator të specializuar, që të ulen më anësh, pak më larg nga nxënësit.
2. **SHPËRNDANI PLANIFIKIMET E JUAJA PËR MËSIMIN** – Nuk jeni vetëm. Shpërndani planifikimet e juaja. Ekipi inkluziv mund t'i modifikojë, që t'i dilni në ndihmë të nevojave të nxënësve me NVA.
3. **JU FLISNI DIREKT NXËNËSVE** –Shmangni që tu drejtoheni nxënësve me NVA përmes përcjellësve të tyre. Përshëndetuni direkt, drejtojuni direkt kur u sqaroni dhe pyetni drejtpërsëdrejti ata.
4. **NDRYSHONI METODAT E JUAJA PËR MËSIM** –Ta bëni mësimin përvojë aktive për të gjithë nxënësit. Formoni grupe koperative për mësim. Siguroni një turmë nga resurset e materialeve dhe paramendoni aktivitete të ndryshme. Bëni që nxënësit të ua demonstrojnë dijen në mënyra të ndryshme.
5. **NJIHNI NXËNËSIT TUAJ** – Përshëndetni nxënësit kur hyjnë në klasën tuaj. Ashtu do të jeni si shembull për ta dhe do t'i mësoni në shkathtësi komunikative dhe sociale. Pyetni diçka për në shtëpi, për të përkëdhelurit e tyre, për jetën e tyre shoqërore.
6. **ÇDO DITË PARASHTRONI PYETJE NGA PËRMBAJTJET** –Kur nxënësit përgjigjen në këta pyetje, përveç asaj që i mësojnë përmbajtjet, ata i ushtrojnë edhe shkathtësitë sociale dhe komunikative. Vlerësimi joformal dhe përcjellje, mund të sigurojnë informata të dobishme për modifikim eventual të mësimin.
7. **PRISNI SUKSES** – Prisni që të gjithë nxënësit të marrin pjesë dhe të mësojnë në orë. U tregoni nxënësve se cilat janë të pritura e juaja nga ata. Përshtatni kërkesat, aktivitetet, që detyrat të përgjigjen në mundësitë e nxënësve.
8. **VENDOSNI QËLLIME TË QARTA TË MËSIMIT** – Punoni me ekipin inkluziv që t'i sqaroni qëllimet mësimore të nxënësve me NVA. Vërtetoni se nxënësit tuaj a punojnë në kontinuitet drejt përbushjes së qëllimeve të tyre. Vlerësojeni dijen e nxënësve pavarësisht nivelit të tyre të dijeve dhe mundësive.
9. **SILLUNI NDAJ TË GJITHË NXËNËSVE NJËLLOJ** – Mbani pritjet e juaja për sjelljen dhe metodave për sigurimin e disiplinës dhe shfrytëzoni të gjithë nxënësit njëlloj dhe kërkoni që t'i respektojnë edhe të rriturit tjerë në klasë.
10. **SHPËRNDANI SHQETËSIMET DHE QËNDRIMET E JUAJA** – Tregoni shqetësimet e juaja dhe mendimet. Shprehni ato me fjalë adekuate. Në vend që të thoni: „Mendoj se ky nxënës nuk takon këtu!“ Përpiquni me „Si mund ta bëj materialin më të kuptueshëm për këtë nxënës?“

**Shtojca 3/8. ÇEK LISTA PËR STRATEGJITË PËR PUNË ME NXËNËS ME NVA****PËRSHTATJA E KUSHTEVE PËR PUNË ME NXËNËS ME NVA**

Emri dhe mbiemri i nxënësit: \_\_\_\_\_ Kl.: \_\_\_\_\_

**1. ZHVENDOSJE FIZIKE DHE PËRSHTATJA NË KLASË:**

- Nxënësi ulet afër arsimtarit
  - Nxënësi ulet afër shembullit pozitiv
  - Gjithçka qëndron afër nxënësit kur jepen udhëzime ose kur ligjërohet (mbahet mësim).
  - Distancim nga stimulimet të cilat tërheqin vëmendjen
  - Organizohet puna me grupe
  - Tjetër: \_\_\_\_\_
- 

**2. Mësimdhënie:**

- Nxënësit janë të ndarë në çifte ashtu që të mund ta kontrollojnë punën e vetë
  - Përkrahja e nxënësve e siguruar (ndihmë në mësim)
  - Në tabelë shënohen fjalët kyçe nga njësia mësimore
  - Mjete ndihmëse të siguruara, shkronja të mëdha, filma, skema, paraqitje grafike
  - Ligjërohet në mënyrën me të cilën vijnë në shprehje më shumë shqisa: Vizuele, auditive, kinestetike
  - Pasi të jenë dhënë udhëzimet për punë, nxënësit i përsëriten udhëzimet dhe nga ai kërkohet që t'i përsëris dhe të tregojë/sqarojë se çfarë duhet të punojë
  - Pëveç udhëzimeve gojore, mund të jepen edhe të shkruara që të mund nxënësi që përsëri t'i kontrolloj dhe të kujtohet në kërkesat
  - Nxënësit i jepet pasqyrë e shkruar/plan me termet (kuptimet) kryesore nga mësimi i orës
  - I lejohe nxënësit që ta inçizojë mësimin e orës që të mund më vonë, ta kontrolloj dhe që më lehtë ta mësoj
  - Nga nxënësi kërkohet që me gojë të jep pasqyrë të fjalëve kyçe nga mësimi
  - Jepet shembull praktik në tabelë që të mund të përgjigjet në kërkesat
  - Nënvizohet dhe theksohen pjesë nga teksti/mësimi që të mund më lehtë ta gjejë idenë kryesore/detaj
  - Mësimdhëniet më të gjata ndahen në pjesë më të shkurtëra
  - Tjetër: \_\_\_\_\_
-

**3. Detyra:**

- Jepet kohë shtesë për fërfundimin e detyrës
  - Udhëzimet e komplikuara thjeshtësohen
  - Zvogëlohet niveli dhe shkurtohet teksti në detyrat
  - Kërkohen më pak përgjigje të sakta për t'u kryer (Kualitet ndaj kuantitetit)
  - Shkurtohen detyrat me ndarjen e të njejtave në pjesë më të vogla
  - Nxënësit ti lejoheq që detyrën ta shkruaj me kompjuter individualisht ose të ia diktoj dikujt dhe të njejtën ta shtyp
  - Shfrytëzohen lista kontrolluese, skema, kartela për rikujtim etj. Për vetëkontollë
  - Zvogëlohet numri i detyrave shtëpiake, veçanërisht detyrat të cilat kanë të bëjnë me më shumë lexim
  - Gjatë punimit të detyrave, lejoheq shkrimi me germa të shtypit në vend të atyre të dorës
  - Përcillen detyrat me të cilat nxënësi e përcakton dinamikën vetanake në mësim (ditore, javore)
  - Nxënësi shkon në shtëpi me udhëzime konkrete dhe të qarta për punimin e detyrës shtëpiake
  - Pjesëmarrja gojore e nxënësit në orë pranohet dhe lavdërohet
  - Tjetër: \_\_\_\_\_
- 

**4. Ushtrime kontrolluese dhe teste:**

- Lejoheq punimi i testeve me libër të hapur
  - Jepen teste me gojë
  - Jepen teste të cilat përpunohen në shtëpi
  - Lejohen të jep përgjigje të inçizuara (në diktafon)
  - Organizohet kuiz, në vend të testit
  - Jepet kohë shtesë për përgjigje në test
  - Nxënësit i lexohen pyetje nga testi
  - Në vend të nxënësit, arsimtari i shkruan përgjigjet në pyetjet nga testi
  - T'i iket presionit ndaj nxënësit në lidhje me kohën ose konkurencën
  - Tjetër: \_\_\_\_\_
-

**5. Organizimi:**

- Sigurohet ndihmë nga pjesëmarrësit gjatë organizimit të punës
- Përcaktohet një sistem për ndërlidhje mes shënimeve dhe detyrave
- Caktohet një shok-vullnetar i cili do t'i ndihmojë rreth detyrave të shtëpisë
- Sigurohet që nxënësi në shtëpi të ketë libra komplet si shtesë
- Që më parë përgatitet orar për mësim/shkrim me nxënësin
- Prindit/kujdestar i dërgohen raporte ditore-javore për përparimin (të rregullta, informime telefonike)
- Ekziston sistem për stimulim (dhurata), për punën e kryer në shkollë dhe detyrave të shtëpisë
- Nxënësit i jepet fletore interesante për të shkruar detyrat e shtëpisë
- Tjetër: \_\_\_\_\_

**6. Sjellja:**

- Thjeshtësohen rregullat në klasë
- Shfrytëzohet mates i kohës për lehtësimin në kryerjen e detyrës
- Cakton kohë për pushim dhe kohë të lirë
- Publikisht lavdërohet sjellja e caktuar
- Shfrytëzohen strategji të caktuara për vetëkontrollë
- Jepen privilegje të veçanta /drejtime pozitive dhe nxitje
- «Me urtësi shfrytëzohen» pasojat negative
- Lejohen pushime të shkurtëra mes detyrave
- Nxënësit i rikujtohet që mos ta ndërprejë punën rreth detyrës (sinjale joverbale)
- Vlerësohen përgjigjet e sakta të nxënësit, dhe jo gabimet e tij
- Realizohet sistem të udhëheqjes me sjelljen në klasë
- Lejohet lëvizje e lejuar, kohë ku nxënësi nuk është në vendin e tij (P.sh. është dërguar që të kryej përfundojë diçka)
- Injorohet sjellja jo adekuate e cila nuk është jashtë kufinjëve të së lejuarës në klasë
- Nxënësit i jepen përgjegjësi të thjeshta në klasë si (p.sh. që të kujdeset për mjetet konkretizuese)
- Me nxënësin merret vesht
- Tjetër: \_\_\_\_\_

Arsimtari: \_\_\_\_\_

## Lëmia 4: Përkrahja e nxënësve

Kujdesi për EISH për nxënësit NVA ka të bëjë me mësimin e tyre dhe përparimin, por edhe më gjërë. Ata janë nxënës të cilët janë më tepër emocional dhe mu për atë është e nevojshme që të sigurohen mekanizma adekuat për preventivë, mbrojtje dhe përkrahje.

### 4.1 Kujdesi i përgjithshëm për nxënësit

#### 1. Protokol për mbrojtje nga lëndimet fizike

- 1.1. Ekipi shkollor inkluziv para fillimit të vitit shkollor me komisionin për kujdesin ndaj shëndetit, merren vesht për intervenimet e nevojshme dhe ndërmarrje të masave preventive për mbrojtje të shëndetit dhe sigurinë e nxënësve me PNA. (Shtojca: 4/1)
- 1.2. Ekipi inkluziv, për nxënësit me NVA, bën procedura individuale dhe përcakton përgjegjësi për sigurinë e tyre.

#### 2. Protokol për preventivë nga dhuna

- 2.1. Ekipi inkluziv shkollor, me ekipin për Preventivë nga dhuna, bashkëngjitet në përgatitjen e politikës për preventivë nga dhuna, në të cilën janë të definuara të gjitha format e sjelljes së fëmijëve dhe të rriturit të cilët merren si dhunë, në veçanti duke patur kujdes që të jenë të mbrojtur fëmijët me PNA dhe fëmijët e edukuar me probleme të sjelljes. (Shtojca: 4/2, 4/3, 4/4)
- 2.2. Ekipi inkluziv shkollor i bashkëngjitet planifikimit dhe realizimit të aktiviteteve, punëtori, debate, dhe ngjarje të ngjashme për zhdukjen e stereotipeve, paragjytimeve dhe diskriminimit; pranimi i dallimeve – në nivel të shkollës dhe në nivel të paraleles në të cilën janë prezente dëto dukuri.

#### 3. Protokol për përkrahje të nxënësve me të meta trupore në zhvillim

- 3.1. EISH përgatit politikë shkollore për përkrahje të nxënësve me të meta trupore. Që të mundësojë qasje në shkollë (Lloz në hyrje për ndalesë; ashensor; rrethojë shkallësh dhe përgjatë korridoreve; toaleta adekuate) bashkëpunon me vetqeverisjen lokale, Këshillin e prindërve, organizata joqeveritare dhe të tjera.

3.2. Ekipi inkluziv për nxënës mundëson përkrahje bahkëmoshatarësh për lëvizjen në klasë, objektin shkollor dhe oborrin shkollor (Shtojca: 4/5, 4/6)

3.3. Ekipi inkluziv kujdeset për orarin e orëve (lëvizja nga njëra në klasën tjetër të jetë në rrugën më të përshtatshme) dhe kujdeset për lëvizjen e papenguar në klasë.

#### 4. Protokol për përkrahje të nxënësve me probleme shëndetësore

- 4.1. Për nxënësit të cilët për shkak të sëmundjeve kronike ose të lëndimeve më serioze të cilët më gjatë mungojnë në mësimin e rregullt, ekipi inkluziv propozon procedura për përkrahje në mësim Shtojca: 4/7, 4/8).
  - Sipas nevojës dhe merrrëveshjes me familjen e nxënësit, ekipi organizon vizitë dhe mësim nga ana e arsimtarëve dhe nga ana e pjesëmarrësve.

#### 5. Protokol për përkrahje të nxënësve nga familjet e rrezikuara sociale

- 5.1. Ekipi inkluziv, sipas nevojës i këshillon dhe i ndihmon prindërit e nxënësve nga familjet e rrezikuara sociale që t'i sigurojnë të drejtat nga mbrojtja sociale nëpërmjet Insitucioneve sociale.
- 5.2. Ekipi inkluziv në bashkëpunim me komisionin e kryqit të kuq në shkollë planifikojnë dhe realizojnë aksione humanitare nga llojet më të ndryshme: Ekspozita shitëse; donacione nga prindërit përmes këshillit prindor; donacione nga ndërmarrjet lokale; ushqim të ngrohtë pa pagesë në shkollë dhe të ngjashme. (Shtojca: 4/9)

#### 6. Protokol për përkrahje për nxënësit me probleme emocionale

- 6.1. EISH mbledh të dhëna për nxënësit me vështirësi emocionale, pvarësisht nga shkaqet – dhunë familjare, pakujdesi familjare, shkurorëzim të prindërve, sëmundje në familje, trauma postkonfliktuale (Shtojca: 4/10)
- 6.2. EISH bo Në bashkëpunim me prindërit dhe



institucionet relevante – institucionet shëndetësore, qendrat për punë sociale, policinë, gjen zgjidhje, ofron ndihmë adekuate dhe përkrahje me në ballafaqim me sfidat.

## 7. Protokol për përkrahje të nxënësve me prirje dhe të talentuar

- 7.1. EISH mbledh të dhëna për nxënësit me prirje dhe të talentuar dhe nga arsimtarët kërkon të përgatisin programe adekuate për realizim të mësimin shtues, që t'i kyçin në gara të ndryshme, hulumtime, ngjarje, debate, ekipe, komisione dhe të ngjashme. (Shtojca: 4/11 – 4/19)

## 8. Protokol për përkrahje të nxënësve me NVA nga asistentë/përcjellës

EISH jep informacione dhe drejtime për punë të asistentëve/përcjellës (të angazhuar nga shkolla, ose nga prindërit ) të nxënësve me NVA.

EISH i ndihmon arsimtarit dhe asistentit/përcjellësit që ta planifikojnë rolin e asistentit/përcjellës në përkrahje të nxënësit në shkollë.

EISH e përcjell punën e asistentit/përcjellësit, i jep drejtime dhe udhëzime për punë më efektive me nxënësin.

### 4.2. Përcjellja e përparimit

#### 1. Protokol për udhëheqje të evidencës për përparimin individual të nxënësve

- 1.1. Ekipi Inkluziv Shkollor përqipet që arsimtarët të mbajnë evidencë të plotë dhe të rregullt për të arriturat, rregullshmërisë dhe sjelljen, si dhe për zhvillimin emocional, social dhe intelektual të nxënësve me NVA.

- Në evidencën në veçanti janë të theksuara anët e mira të nxënësit dhe potencialet zhvillimore të tij.
- Në evidencën janë futur edhe të dhënat për përparimin e nxënësit dhe janë fituar si rezultat i vlerësimit të bërë nga ana e arsimtarëve, në bashkëpunim me shërbimin profesional dhe prindërit e nxënësit. (Shtojca: 4/20 – 4/33)

#### 2. Protokol për analizë të përparimit të nxënësve sipas paraleleve

- 2.1. Në fund të çdo tremujori (ose në fund të çdo muaji) ekipi inkluziv bën analizë të përparimit të nxënësve me NVA.
- 2.2. Pas përfundimit të analizës vërtetohet se nxënësi a ka përparim dhe mund të kalojë në marrjen e njohurive të reja ose do të ketë nevojë për ndërrimin e strategjisë në mësim për periudhën në vazhdim.
- 2.3. Raportet e përgatitura dhe analizat për nxënësit me NVA lëshohen në qasje, pamje të shërbimit profesional dhe kuadrit udhëheqës dhe janë në shqyrtim, të kapshme edhe për të gjithë arsimtarët tjerë dhe prindërit dhe vetë nxënësit .

#### 3. Protokol për përkrahje dhe përcjellje të përparimit në arsimin e mesëm

- 3.1. Ekipi inkluziv shkollor kujdeset në veçanti që t'i kushtohet kujdes orientimit profesional dhe këshillim të nxënësve me NVA dhe për atë qëllim bashkëpunon me ekipin shkollor për orientim profesional (psikolog/pedagog, kujdestarët e klasave dhe prindërit).
- 3.2. Ekipi inkluziv shkollor përqipet që shkolla të sigurojë informacione për regjistrim të nxënësve me NVA në arsimin e mesëm dhe për suksesin e tyre në vitin e parë dhe i analizon të dhënat e marra.
- 3.3. Gjatë pranimit të nxënësit me NVA nga shkolla fillore në shkollë të mesme, Ekipet inkluzive shkollore nga shkolla fillore dhe e mesme patjetër duhet të mundësojnë të gjitha informacionet relevante për nxënësin në mënyrë të sigurtë dhe të besueshme të barten, me çka do të mund të mundësohet vazhdimi i procesit edukativo-arsimor në mënyrën të cilën do të jetë në interesin më të mirë të nxënësit.
- 3.4. Në bazë të rezultateve të fituara nga të dhënat e mara EISH propozon masa për përmirësimin e praktikave inkluzive në shkollë.

# SHEMBUJ TË INSTRUMENTEVE DHE MODELE TË DOKUMENTEVE PËR FUSHËN 4

## Shtojca 4/1. PREVENTIVA NGA RREZIQET E MUNDSHME PËR SIGURINË E NXËNËSVE (ME NVA)

### RREZIQET E MUNDSHME PËR SIGURINË E NXËNËSVE (ME NVA)

(instrumenti plotësohet para se të realizohet ndonjë aktivitet specifik/projekt me nxënës me NVA që të sigurohet siguria e tij dhe të shmangen rreziqet)

Emri dhe mbiemri i nxënësit: \_\_\_\_\_, klasa. \_\_\_\_\_

Përshkrimi i aktivitetit:

--

Realizuar nga: \_\_\_\_\_, data: \_\_\_\_\_

#### Hapi 1: Identifikimi i rreziqeve

Biologjike (higjiena, sëmundjet, infektimet, alergjitë)		
<input type="checkbox"/> Gjaku / Lëngjet trupore	<input type="checkbox"/> Virusë / sëmundje	<input type="checkbox"/> Alergji
Të tjera / detaje:		
Kimikale (mjete për pastrim, substanca për eksperimente, etj.) – kimikalet duhet të jenë të shënuara dhe të përcjellura me udhëzime		
<input type="checkbox"/> Kimikale jo të rrezikshme	<input type="checkbox"/> Kimikale të rrezikshme	
Emëroni kimikalet / detaje:		
Situata kritike – incidente që rezultojnë me:		
<input type="checkbox"/> Mbyllje	<input type="checkbox"/> Evakuim	<input type="checkbox"/> Rrënim
Të tjera / detaje:		
Incidente nga burimet energjetike / probleme të cilat kyçin:		
<input type="checkbox"/> Rrymë elektrike	<input type="checkbox"/> Gaz / naftë / zjarr	<input type="checkbox"/> Gaz të kompresuar
Të tjera / detaje:		
Mjedisi:		
<input type="checkbox"/> Ekspozimi në diell	<input type="checkbox"/> Uji (burimi, lumi, plazhi, penda)	<input type="checkbox"/> Zëri, zhurma
<input type="checkbox"/> Shtazë / insekte	<input type="checkbox"/> Stuhi / probleme me motin	<input type="checkbox"/> Temperatura (nxehetë, ftohtë)

Të tjera / detaje:					
Objekte / ndërtime në rrethinë:					
<input type="checkbox"/> Ndërtime dhe objekte nga rrethina të cilat nuk zhvendosen		<input type="checkbox"/> Rrugë / shteg		<input type="checkbox"/> Punëtori / dhomë pune	
<input type="checkbox"/> Paisjet për terrenet /palestrat		<input type="checkbox"/> Mobilje		<input type="checkbox"/> Pishinë	
Të tjera / detaje:					
Maqina, vegla dhe paisje					
<input type="checkbox"/> Maqina - statike		<input type="checkbox"/> Maqina – zhvendosëse		<input type="checkbox"/> Vegla dore	
<input type="checkbox"/> Automjete / rimorkio		<input type="checkbox"/>		<input type="checkbox"/>	
Të tjera / detaje:					
Punë manuele:					
<input type="checkbox"/> Punë manuele (që përsëritet, e vështirë)		<input type="checkbox"/> Aktivitet në lartësi		<input type="checkbox"/> Hapësirë e kufizuar	
Të tjera / detaje:					
Dhunë:					
<input type="checkbox"/> Nxënës		<input type="checkbox"/> Të punësuar		<input type="checkbox"/> Prind / të tjerë	
<input type="checkbox"/> Fizike	<input type="checkbox"/> Psiqike	<input type="checkbox"/> Fizike	<input type="checkbox"/> Psiqike	<input type="checkbox"/> Fizike	<input type="checkbox"/> Psiqike
Rreziqe tjera / detaje:					

## Hapi 2: Notimi i nivelit të rrezikut

Duke patur parasyshë rreziqet e identifikuara në hapin paraprak dhe duke shfrytëzuar matricën e dhënë për notim, notoni nivelin e rrezikut.


Gjasa	Pasoja				
	E pamundur	E vogël	Mesatare	E madhe	Kritike
Gati se sigurtë	Mesatare	Mesatare	Lartë	Ekstreme	Ekstreme
Me gjasë se	Ulët	Mesatare	Lartë	Lartë	Ekstreme
E mundshme	Ulët	Mesatare	Lartë	Lartë	Lartë
E pamundur	Ulët	Ulët	Mesatare	Mesatare	Lartë
Rrallë	Ulët	Ulët	Ulët	Ulët	Mesatare

Pasoja	Përshkrimi i pasojës	Pasoja	Përshkrimi i pasojës
E pamundur	Nuk ka nevojë për trajtim	Rallë	Ndodh vetëm në rrethana të veçanta
E vogël	Lëndimi i vogël kërkon trajtim me komplet për Ndihmën e parë (prerje të vogla, të shtypura)	E pamundur	Nuk mund të ndodh në të ardhmen e afërt ose në korniza gjatë ciklit të projektit
Mesatare	Lëndimi kërkon trajtim medicinal ose më shumë kohë	E mundshme	Mund të ndodh në një të ardhme të afërt ose në korniza gjatë ciklit të projektit
E madhe	Lëndim serioz që kërkon trajtim medicinal specialistik ose hospitalizim	Më se e mundshme	Ka gjasa që të ndodh në korniza gjatë ciklit të projektit
Kritike	Humbja e jetës, pengesë e përjetëshme ose lëndime të shumëta serioze	Gati se sigurtë	Gati se sigurisht do të ndodh në korniza gjatë ciklit të projektit

Niveli i rrezikut		Përshkrimi i nivelit të rrezikut	Aksioni
<input type="checkbox"/>	I ulët	Nëse ndodh incident, gjasat janë të vogla që të rrezulton me lëndim.	Kryeni aktivitetin me kushtet ekzistuese në vendin e ngjarjes.
<input type="checkbox"/>	Mesatar	Nëse ndodh incident, ka ndonjë gjasë për lëndim që kërkon përdorimin e kutisë për Ndihmën e parë.	Do të nevojiten strategji plotësuese.
<input type="checkbox"/>	I lartë	Nëse ndodh incident me siguri lëndimi kërkon trajtim medicinal.	Duhet të përdoret strategji para se të realizohet aktiviteti. Duhet të ndiqen protokole të repta për tu siguruar siguria.
<input type="checkbox"/>	Ekstrem	Nëse ndodh incident, me siguri do të rrezulton me lëndim permanent ose vdekje.	Shqyrtoni alternativa për realizimin e aktivitetit. Duhet të ndiqen protokole të repta për tu siguruar siguria.

### Hapi 3: Kontrolloni rrezikun

1. Në tabelën e mëposhtme përmendni rreziqet e mundshme
2. Notoni nivelin e rrezikut
3. Sqaroni masat të cilat do ti përdorni për t'a eliminuar ose t'a zvogëluar rrezikun sipas Hierarkisë së dhënë të strategjive / procedurave

Hierarkia e strategjive	
<p>Më shumë efektiv (niveli i lartë)</p>  <p>Më pak efektiv (niveli i ulët)</p>	<b>Eliminimi:</b> Menjanimi i tërësishëm i rrezikut nga aktiviteti ose vendi i punës
	<b>Alternativa:</b> Zgjedhja e aktivitetit më të sigurtë
	<b>Ridizajnimi:</b> Bëni aktivitetin ose procesin më të sigurtë
	<b>Izolimi:</b> Menjanoni njerëzit nga rreziku
	<b>Administrata:</b> Vendosni rregulla, shenja ose udhëzime për ta siguruar vendin e punës ose realizimin e aktivitetit
	<b>Paisjet personale mbrojtëse:</b> Veshëmbathje mbrojtëse dhe pajisje të tjera

**Rreziqe dhe strategji**

Përshkrimi i rrezikut	Niveli i rrezikut	Strategjia
Detaje tjera:		

**Hapi 4: Revizioni i strategjive**

Parashtrimi	
<p>Aktiviteti do të realizohet në pajtim me vlerësimin për rrezik, duke përdorur ndonjërin nga strategjitë e përmendura nga hapi 3. Nëse është e nevojshme do të bëhen ndryshime të aktivitetit që të menjahen rreziqet eventuale dhe të sigurohet siguria.</p>	
Personi për kontakt:	Data:
Përmendni personat e tjerë të cilët janë të kyçur në këtë vlerësim për rrezik:	

**Hapi 5: Pasqyra dhe revidimi i strategjive**

Plotësoni për kohën / ose sipas aktivitetit	Po	Jo
1. A ishin strategjitë e planifikuara të mjaftueshme dhe efektive për zvogëlimin e niveli të rrezikut?	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2. A janë bërë ndryshime në strategjitë e planifikuara?	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3. A është e nevojshme që në të ardhmen të zbatohet strategjia?	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Detaje:		
Pasqyrën e ka bërë:	Në rol të:	
Nënshkrimi:	Data:	

## **Shtojca 4/2. PROCEDURA PËR KUJDESIN E NXËNËSVE ME INVALIDITET TRUPOR DHE SHIKIM TË DËMTUAR**

### **PROCEDURA PËR KUJDESIN E NXËNËSVE ME INVALIDITET TRUPOR DHE SHIKIM TË DËMTUAR**

1. Organizimi i procesit mësimor në pajtim me nevojat e nxënësit me invaliditet trupor:
  - Caktimi i hapësirave në të cilat do të ndiqet mësimi varësisht nga mundësia për mobilitet të nxënësit me invaliditet trupor;
  - Caktimi i ndihmësve, bashkënxënës të tij të cilët do ti ofrojnë përkrahje të vazhdueshme në pajtim me nevojat e tija të cilat do të ndryshojnë në mënyrë ciklike për një javë;
2. Përgatitja e Planit individual arsimor.
3. Arsimtari dhe bashkëpunëtorët profesional ndjekin sjelljen e nxënësit dhe përparimin e tij në mësim.
4. Bashkëpunëtorët profesional sipas nevojës e udhëzojnë prindin dhe nxënësin në institucion përkatës profesional.
5. Arsimtari dhe bashkëpunëtorët profesional i japin nxënësit përkrahje të vazhdueshme për përparimin e tij të suksesshëm.

Arsimtari dhe bashkëpunëtorët profesional janë në bashkëpunim dhe komunikim të vazhdueshëm dhe në te është i kyçur edhe nxënësi me invaliditet trupor si dhe prindi i nxënësit.

**Shtojca 4/3. REKOMANDIME PËR PËRKRAHJE NDËRMOSHATARE****REKOMANDIME PËR PËRKRAHJE NDËRMOSHATARE**

Emri dhe mbiemri i arsimtarit: \_\_\_\_\_

Data: \_\_\_\_\_

Nxënësit vijues i rekomandoj për dhënien e përkrahjes ndërmoshatare:

<i>Emri dhe mbiemri i nxënësit:</i>	<i>Klasa:</i>	<i>Shkaqet për zgjedhjen:</i>	<i>Lloji i përkrahjes:</i>	<i>Afati kohor:</i>	<i>Nxënësi që pranon përkrahjen:</i>

**Shtojca 4/4. PRECEDURA PËR KUJDESIN PËR NXËNËSIT ME PROBLEME SHËNDETËSORE****PRECEDURA PËR KUJDESIN PËR NXËNËSIT ME PROBLEME SHËNDETËSORE, SËMUNDJE KRONIKE OSE LËNDIME TË RËNDA**

1. Prindi është i obliguar ta informon shkollën për gjendjen shëndetësore të fëmijës së tij në rast se ajo është e çrregulluar, si dhe për llojin e sëmundjes dhe aspektet në të cilat duhet patur kujdes në shkollë.
2. Në kushte kur fëmija do të ankohet në probleme shëndetësore ose lëndime gjatë kohës së mësimin, menjëherë reagohe në mënyrën vijuese:
  - Informohet kujdestari klasor ose shërbimi profesional.
  - Kontaktohet me prindin dhe informohet për problemin.
  - Nxënësi nuk lejohet që të shkojë vetë në shtëpi derisa nuk merr leje nga prindi – është e dëshirueshme që prindi të vjen dhe ta merr fëmijën, në rast se kjo nuk është e mundëshme, shkolla duhet të jetë e sigurtë se dikush është në shtëpi i cili do ta pranon – në rast se bëhet fjalë për ndonjë rast specifik caktohet arsimtari i cili do ta përcjellë deri në shtëpi.
  - Në shkollë reagohe gjatë lëndimit i cili mund të sanohet lokalisht, gjatë së cilës shfrytëzohen përmbajtjet nga kutia për Ndhimën e parë.
  - Nuk guxojmë që nxënësve t'ju japim barëra të cilat merren në mënyrë orale, për shkak të mundësisë që fëmija mund të jetë alergjik në ndonjë barë.
  - Gjatë rasteve të shpejta nxënësi bartet në ambulancën më të afërt ku do ti ofrohet ndihma mjekësore dhe njëkohësisht informohet prindi për ate se si është vepruar.
3. Pasi që nxënësi do të jetë në përkujdesje dhe do ti jepet ndihma, kujdestari klasor informohet dhe e ndjek gjendjen shëndetësore të tij, me qëllim që gjatë mësimin të ketë përkujdesje të aspekteve kritike (p.sh. – lirimi nga lodhja fizike, kujdesi nga kushte higjienike të caktuara, kontrollimi i ushqimit, etj).
4. Gjatë rasteve të sëmundjeve kronike ose lëndimeve më të rënda:
  - Shkolla është e obliguar ti ndjek kahjet të cilat i ka dhënë prindi në bazë të rekomandimeve të mjekut dhe rregullisht ta informon prindin për ndryshimet të cilat ndodhin dhe që janë vërejtur.
  - Në rast se nxënësi një kohë më të gjatë mungon nga mësimi, shkolla është e obliguar ti siguron resurse për mësim në kushte shtëpiake, gjegjësisht të organizon mësim shtëpiak.
  - Mësimi shtëpiak përfshin:
    - organizimi i mënyrës me të cilën materialet do të dorëzohen nga arsimtari te nxënësi dhe anasjelltas;
    - ndihma nga ana e arsimtarëve në kuptim të dhënies kahjeve nxënësit dhe prindërve të tij në lidhje me përvetësimin e përmbajtjeve mësimore, në lidhje me shfrytëzimin e materialeve mësimore, punimi i detyrave të shtëpisë dhe i gjithë asaj që është punuar në shkollë në ditën vijuese;
    - organizimi i ndjekjes në vijim të të arriturave (fletat mësimore, detyrat e punës, hartimet) dhe dhënia e informatave kthyesë me shkrim;
    - udhëheqja e portfolios për nxënësin në të cilën do të shihet se si ka rrjedhë procesi i mësimdhënies dhe ndjekja e të arriturave;
    - arsimtari, në rast se medon se është e nevojshme, mund ta viziton nxënësin në shtëpinë e tyre dhe ti jep ndihmë plotësuese në mësim.
  - Prindi duhet të siguron dhe të dorëzon në shkollë dokumentacionin e duhur nga mjeku me të cilin vërtetohet se nxënësi ka nevojë për të munguar më gjatë nga mësimi. Ky dokumentacion është me karakter të besueshëm dhe ruhet tek bashkëpunëtorët profesional në shkollë.



**Shtojca 4/5 – a. Formulari për organizim të mësimit në kushte shtëpiake**

Nxënësi: \_\_\_\_\_ Paralelja: \_\_\_\_\_

Periudha: \_\_\_\_\_

Lënda/arsimtari	Informata për përmbajtjet për mësimit	Detyrat e dhëna të shtëpisë	Detyra shtëpie të përgatitura dhe informata kthjese

Arsimtari klasor/ Kujdestari i klasës

\_\_\_\_\_

**Shtojca 4/5-b. KUJDESI PËR NXËNËSIT ME PROBLEME SHËNDETËSORE****KUJDESI PËR NXËNËSIT ME PROBLEME SHËNDETËSORE**

Emri dhe mbiemri i nxënësit:
Aktivitetet e planifikuara:
<i>Planifikohen përmbajtje për grupet e nxënësve të rrezikuar për të cilët rekomandim jep kujdestari i klasës, këshilli i arsimtarëve klasor, këshilli i arsimtarëve lëndor, shërbimi profesional, në bashkëpunim me prindët.</i>
Aktivitete të ndërmarra:
Përmbajtja e definuar qartë  Raporti
Pjesëmarrës:
Arsimtari përgjegjës: _____  Data: _____

**Shtojca 4/6. KUJDESI PËR NXËNËSIT NGA FAMILJET E RREZIKUARA SOCIALE****PROGRAMI PËR KUJDESIN PËR NXËNËSIT NGA FAMILJET E RREZIKUARA SOCIALE**

Aksione takuese / ngjarje / ndodhi / hepeningje / aktivitete tjera interne	Përmbajtje dhe qëllime të defnuara qartë dhe dhe kërkesë e lejuar për realizim	Data e realizimit	Persona përgjegjës	Raporti

**Shtojca 4/7. PASQYRA E GRUPEVE TË NXËNËSVE TË RREZIKUAR**

<b>GRUPET E NXËNËSVE TË RREZIKUAR</b>							
* mund të shënohen edhe më shumë kolona	Perspektiva shëndetësore – barrierat në mësim për shkaqe shëndetësore (sëmundje kronike dhe sëmundje afatgjate)	Perspektiva zhvillimore – barrierat në mësim lidhur me zhvillimin e nxënësit (emocional dhe intelektual)	Perspektiva e raporteve dhe lidhjeve – barrierat në mësim lidhur me komunikimin	Perspektiva e programit mësimor – barrierat që kanë ndodhur nga lëshimet e mëdha në dituritë e mëparëshme	Perspektiva gjuhësoro – kulturologjike barrierat si pasoja të gjuhës tjetër folëse dhe kulturës	Perspektiva ekonomike – barrierat si pasoja të situatës së vështirë ekonomike	Perspektiva familjare – barrierat si pasoja familjeve disfunksionale: dhuna; varshmëria; prind të vetëm
Klasa: _____ Kujdestari i klasës:							
Emri dhe mbiemri i nxënësit:							
Gjithësej:							

Shtojca 4/8. NDJEKJA E NXËNËSVE ME NVA

Lista për ndjekjen e zhvillimit të nxënësit (Klasa I-V)

Emri dhe mbiemri i nxënësit: \_\_\_\_\_, klasa \_\_\_\_\_, viti shkollor: \_\_\_\_\_

Lënda mësimore	Indikatorët	Gjuhë amtare	Matematikë	Shkenca natyrore	Shoqëri	Arsim figurativ	Arsim muzikor	AFSH	Arsim teknik	Gjuhë angleze	Sipas tremujoreve / kuartaleve		
											I	II	III
Tema:	Përvetësimi i materialit sipas lëndëve										I	II	III
	I vëren gjërat e rëndësishme										I	II	III
	I lidh faktet										I	II	III
	Gjykon në mënyrë kritike										I	II	III
	Reprodukon në mënyrë të pavarur										I	II	III
	Lehtë abstrahon dhe përgjithëson										I	II	III
	Shprehet verbalisht										I	II	III
	Shpreh aftësi kreative										I	II	III
	I kalon kornizat programore										I	II	III
	Bën lidhshmëri dhe sjell përfundime me ndihmë										I	II	III
	Mban mend në mënyrë pasive dhe reprodukon										I	II	III
	Shqetësohet në situata të reja										I	II	III
	Vështirë sjell përfundime dhe i përgjithëson										I	II	III
	Mëson me stereotype (sipas shembullit)										I	II	III
	I arrin qëllimet vetëm me ndihmën e të tjerëve										I	II	III

Tema:	Lënda mësimore	Indikatorët	Sipas tremujoreve / kuartaleve																	
			Gjuhë amtare		Matematikë		Shkenca natyrore		Shogëri		Arsim figurativ		Arsim muzikor		AFSH		Arsim teknik		Gjuhë angleze	
1	Aktivitetet në orë	Në të gjitha orët është aktiv	I	II	III	I	II	III	I	II	III	I	II	III	I	II	III	I	II	III
2	Në pjesën më të madhe të orëve është aktiv																			
3	Vetëm në disa orë është aktiv																			
4	Shumë rrallë është aktiv																			

Tema:	Lënda mësimore	Indikatorët	Sipas tremujoreve / kuartaleve																	
			Gjuhë amtare		Matematikë		Shkenca natyrore		Shogëri		Arsim figurativ		Arsim muzikor		AFSH		Arsim teknik		Gjuhë angleze	
1	Raporti ndaj suksesit	Realisht e vlerëson suksesin e vet	I	II	III	I	II	III	I	II	III	I	II	III	I	II	III	I	II	III
2	Suksesi e nxit																			
3	Është i interesuar për suksesin e vet																			
4	Fajëson të tjerët për mosuksesin e vet																			

Lénda mësimore	Indikatorét	Gjuhë amtare	Matematikë	Shkencë natyrore	Shqipëri	Arsim figurativ	Arsim muzikor	AFSH	Arsim teknik	Gjuhë angleze	Sipas tremujoreve / kuartaleve			
											I	II	III	I
<b>Tema:</b>	<b>Raporti ndaj mësimít dhe punës sipas lëndëve</b>													
1	I pavarur													
2	I vetëdijshëm													
3	I qëndrueshëm													
4	Pedant													
5	Sistematik													
6	Iniciator													
7	Kohë pas kohe i duhet nxitje													
8	Kohë pas kohe i duhet ndihmë													
9	Punon jo barabarësisht													
10	Pa qëndrueshmëri të mjaftueshme													
11	Pa iniciativë të mjaftueshme													
12	Nuk është i pavarur													
13	Duhet rregullisht të kontrollohet													
14	Jo i rregulluar													
15	Punon vetëm kur është e domosdoshme													

Tema:	Lënda mësimore	Indikatorët	Sipas tremujoreve / kuartaleve											
			Gjuhë amtare	Matematikë	Shkenca natyrore	Shqiptari	Arsim figurativ	Arsim muzikor	AFSH	Arsim teknik	Gjuhë angleze			
1	Raporti ndaj nxënësve të klasës dhe personave tjerë		I	II	III	I	II	III	I	II	III	I	II	III
2	Lehtë vendos kontakte													
3	Është taktik													
4	Gjen kompromis													
5	Jep iniciativë													
